

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRIË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetellës Kanalizime

2013



Publikuar nga
Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr.10
Tirane, Shqipëri

E-mail: publik@erru.al
Tel.: 00355 4 2258046
Faqja e internetit: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Tetor 2014

ISSN: 2305-3645



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit

Printimi i këtij publikimi u mbështet nga

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programi për Reformën e Ujit, Shqipëri

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Misioni

Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Përmbajtja

Shkurtime	2
Fjala përshëndetëse	26
Hyrje	27
1. ERRU dhe veprimtaria gjatë vitit 2013	29
2. Ecuria e Sektorin Ujësjiellës Kanalizime gjatë vitit 2013	31
3. Analiza e performancës për shoqëritë ujësjiellës kanalizime	36
3.1 Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes	40
3.2 Mbulimi i kostos totale	44
3.3 Norma e Arkëtimit	48
3.4 Efienca e Stafit	52
3.5 Uji pa të ardhura	55
4.6 Niveli i matjes	59
4.7 Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	63
3.8 Cilësia e ujit të pijshëm	66
3.9 Mbulimi me kanalizime	67
3.10 Perceptimi rregullator	71
Liçencimi	72
Tarifat e miratuara nga ERRU	73
Pagesat rregullatore	73
4. Renditja e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime sipas performancës për vitin 2013	75
5. Tema e veçantë e vitit 2013: Bilanci i ujit të pijshëm	80
6. Konkluzione dhe perspektiva në të ardhmen	82
7. Aneks: Të dhënat kryesore të përzgjedhura	85

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Ujësjiellës Kanalizimeve
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
TKP	Treguesve Kryesore të Performancës
SHA	Shoqëri Aksionere
USAID	United States Agency for International Development / Agjencia për Zhvillim e Shteteve të Bashkuara
UNDP	United Nations Development Program / Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
IWA	International Water Association / Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit / Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Kanalizim e Kosovës.
O&M	Kosto operative dhe mirëmbajtje
DPUK	Drejtorisë e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Europian
ISHP	Instituti Shëndetit Publik
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetit Publik
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

Fjala përshëndetëse

Kam kënaqësinë që edhe këtë vit, për të tretin vit rradhazi, të ndaj me ju Raportin e Performancës së Shoqërive Ujësjetëlës Kanalizime për vitin 2013. Ndonëse Enti Rregullator i Ujit e ka filluar relativisht vonë përgatitjen dhe publikimin e këtij Raporti, të gjithë jemi tashmë të vetëdijshëm për rëndësinë e tij, jo vetëm për Shoqëritë që të shikojnë ecurinë e tyre ndër vite si dhe të krahasojnë arritjet e tyre me ato Shoqëri që operojnë në të njëjtin mjedis, apo dhe palët e interesuara si Pronarët, Këshillat Mbikëqyrës, Konsumatorët që të njihen me këtë performance, por dhe për vetë Rregullatorin.

Analiza e trendit të ecurisë së sektorit në tërësi si dhe zhvillimet apo problemet e evidentuara për çdo Shoqëri në veçanti, ndihmojnë në realizimin e misionit të Entit Rregullator, por gjithashtu dhe në përmirësimin e standardeve, metodologjive apo praktikave që ai përdor për të bërë të mundur këtë krahasim performance. Për këtë arsye, pavarësisht se edhe në këtë raport janë marrë të njëjtët tregues në analizë, Enti Rregullator i Ujit, bazuar në eksperiencën tashmë trevjeçare të krahasimit të performancës, po konsideron mundësinë e përshtatjes së standardeve dhe praktikës së vlerësimit të shoqërive, duke shtuar dhe rigrupuar treguesit e performancës të përdorur për vlerësim si dhe peshën e secilit prej tyre.



Nga ana tjetër, megjithëse ky raport përpiket të ofrojë një pamje sa më reale të performancës së Shoqërive, ka akoma shumë vend për përmirësime për sa i përket të dhënave mbi të cilat ai është bazuar. Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion dhe të dhëna të besueshme si dhe për një monitorim të vazhdueshëm. Monitorimi jep mundësinë të bëhet një vlerësim korrekt i performancës së çdo Shoqërie dhe të vendosen objektiva realiste, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të tyre. Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave është tashmë një nga sfidat më emergjente të ERRU-se për vitin në vazhdim.

Përsa i përket vitit 2013 që lamë pas, analiza e treguesve të performancës konfirmoi dhe njëherë problematikat që ka pasur sektori këto vitet e fundit në të dy aspektet kryesore; në menaxhim dhe investim. Pjesa më e madhe e treguesve të marrë në analizë ka pasur një rritje të lehte, ose nivele të njëjta me ato të dy viteve të kaluara. Shoqëritë kanë sërish përmirësime të situatës së tyre financiare, por nga analiza e treguesve përkatës, mendohet që ky përmirësim ka ardhur kryesisht si rezultat i politikës tarifore të zbatuar, ndërsa efekti i ardhur nga reduktimi i kostove apo rritja e faturimit dhe atë me tepër arkëtimit ka qenë më i ulët. Po kështu dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë apo niveli i matjes kanë pësuar një rritje të vogël krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, niveli i humbjeve vazhdon të mbetet një nga problemet më serioze në sektor, me impakt negativ në qëndrueshmërinë financiare të Shoqërive por edhe në cilësinë e ujit për konsum publik.

Sigurisht që përveç problematikave, brenda secilit grup gjenden dhe ato Shoqëri të cilat duhet të përgëzohen, performuesit më të mire të vitit dhe ato me ecurinë më të mirë krahasuar me një vit më parë. Janë këta performues, inkurajues dhe për Shoqëritë e tjera në rritjen e standarteve të shërbimit ndaj konsumatorëve shqiptarë. Ju faleminderit për përkushtimin në punën tuaj dhe në arritjen e objektivave në sektor.

Unë nga ana tjetër, në emër dhe të Entit Rregullator të Ujit, dua t'ju siguroj se gjithmonë do të keni mbështetjen tonë në punën tuaj në zhvillimin e sektorit, pavarësisht sfidave të shumta dhe problemeve.

Në përfundim do të doja të falenderoja të gjithë punonjësit e ERRU-së për punën dhe dedikimin që kanë treguar në përgatitjen e këtij Raporti si dhe këshilltarët e GIZ-it për bashkëpunimin e frytshëm, jo vetëm në këtë raport, por dhe gjatë gjithë këtyre viteve pune të përbashkët.

Avni Dervishi

Kryetar i Entit Rregullator të Ujit





Hyrje

Për të tretin vit radhazi Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura përgatit Raportin e Performancës së operatorëve aktiv në këtë sektor. Raporti i Performancës për vitin 2013 bazohet edhe këtë vit në vlerësimin e aktivitetit dhe shërbimeve të ofruara nga shoqëritë ujësjellës kanalizime në bazë të 10 treguesve kryesorë të performancës të përzgjedhur (TPK) nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen aftëgjatë të qëndrueshmërisë financiare në këtë sektor, në përzgjedhjen e TKP u është dhënë përparësi treguesve që vlerësojnë aspektet financiare dhe menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve. Përparësi kanë treguesit ekonomiko financiar dhe ato të shërbimit të shërbimit të furnizimit me ujë.

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është institucion i pavarur publik, i krijuar në bazë të ligjit nr. 8102, datë: 28.03.1996, mbi “Kadrrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Në zbatim të këtij Ligji Enti Rregullator është i mandatuar për të raportuar ‘mbi gjendjen e sektorit’, dhe të paraqesë rekomandimet e tij lidhur me masat që duhen marrë për përmirësimin e këtij sektori. Raporti mbi performancën e ofruesve të shërbimit dhe sektorit në tërësi është një nga rrugët për të përmbushur këtë detyrim ligjor.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës, me informacion dhe analizat e tij krijon mundësi për të gjithë të interesuarit që të vlerësojnë performancën e çdo operatori dhe të shohin gjendjen dhe ecurinë e sektorit. Konsumatorët mund të vlerësojnë performancën e operatorit që u ofron atyre shërbimin dhe ta krahasojnë atë me performancën e operatorëve të tjerë. Vetë shoqëritë mund të vlerësojnë ecurinë e tyre duke e krahasuar me atë të shoqërive të tjera që operojnë në mjedise të ngjashme. Kështu ato mund të dallojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta e të mësojnë nga praktikatat më efikase operacionale dhe menaxhuese të më të mirëve. Autoritetet vendore si pronare të shoqërive dhe po ashtu Këshillat Mbikqyrës do të gjejnë informacione për të vlerësuar punën e shoqërisë së tyre, por edhe për të marrë vendimet e duhura në lidhje me këto shoqëri. Rezultatet e kësaj analize të performancës do të përdoren gjithashtu nga ERRU në procesin licencimit dhe vlerësimit të zbatimit të kushteve të licencës dhe ndryshimit të tarifave, duke qenë se ndryshimet tarifore varen nga arritja e objektivave të performancës të vendosura nga ERRU.

Informacioni dhe analizat e këtij raporti ndihmojnë vendimmarrësit dhe donatorët në përpjekjet e tyre për të përmirësuar performancën e shoqërive UK dhe sektorit në përgjithësi.

Publikimi i këtij raporti është vazhdimi i procesit të monitorimit të performancës së sektorit nga rregullatori. ERRU dëshiron të nxisë të gjithë aktorët si: shoqëritë, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës, konsumatorët, mediat si dhe vendimmarrësit për t'u angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

ERRU është përgjegjës për rregullimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në vend. Në këtë raport, është analizuar vetëm performanca e 58 shoqërive ujësjellës kanalizime. Aktualisht ky shërbim krahas shoqërive ujësjellës kanalizime ofrohet edhe nga disa operatorë të tjerë që nuk janë të licensuar. ERRU po punon për të orientuar veprimtarinë e tij drejt integritetit të tyre brenda kuadrit rregullator.

Në këtë vlerësim një rol të rëndësishëm luan cilësia dhe saktësia e të dhënave. Me përjashtim të një treguesi, analiza e performancës së paraqitur edhe në këtë raport është bazuar mbi të dhëna e vetëdeklaruara nga ana e shoqërive, të mbledhura dhe të përpunuara nga Njësia e Monitorimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime.

Edhe gjatë vitit 2013 u konstatuan mosraportim, vonesa dhe pasaktësi në të dhënat e raportuara nga disa shoqëri. Kjo përvojë risjell në vëmendjen e ERRU nevojën për të intensifikuar punën në drejtim të raportimit, verifikimit dhe saktësisë të të dhënave të paraqitura nga shoqëritë duke ushtruar aty ku është e nevojshme kompetencat e tij ligjore.

ERRU, me mbështetjen e GIZ dhe në bashkëpunim me aktorët kryesor në sektor, ka përgatitur infrastrukturën logjistike dhe po punon për përmirësimin e cilësisë dhe raportimit të të dhënave. Njëkohësisht po punohet për rishikimin e treguesve të performancës, për të zgjeruar analizën dhe për shërbimin e kanalizimeve dhe trajtimin e ujrave të ndotura. Këto përmirësime do të reflektohen në Raportin e Performancës së vitit 2014.

Raporti është i strukturuar në gjashtë pjesë ku:

Në pjesën e parë paraqiten shkurtimisht veprimtaritë dhe arritjet kryesore të ERRU gjatë vitit 2013. Në pjesën e dytë paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2013. Në pjesën e tretë, e cila është edhe pjesa më e rëndësishme e këtij raporti, paraqitet analiza e performancës së shoqërive, për secilin nga dhjetë TKP e marra në shqyrtim.

E cila paraprin pjesën e katërt të raportit ku jepet renditja e shoqërive në bazë të rezultateve të arritura.

Në pjesën e pestë të raportit trajtohet një nga problemet më të rëndësishme të sektorit; "Humbjet" të analizuara sipas Bilancit të Ujit. Raporti mbyllet me pjesën e gjashtë ku paraqitet një përmbledhje e konkluzioneve kryesore.

Në përfundim është një përmbledhje aneksesh me të dhëna të detajuara për shoqëritë UK dhe tarifatat që ato zbatojnë



1

ERRU dhe veprimtaria gjatë vitit 2013

Enti Rregullator i Ujit është institucioni që ushtron dy funksione të rëndësishme tërësisht të vetat në sektorin ujësjellës e kanalizime: licencimin e operatorëve që veprojnë në këtë sektor dhe vendosjen e tarifave të shërbimit.

Një vëmendje të veçantë Enti i kushton konsumatorit dhe mbrojtjes së tij. Nga viti në vit ERRU ka nxitur rritjen e transparencës në sektor, përcaktimin e procedurave të drejta dhe ka kërkuar nga operatorët konsolidimin e shërbimit ndaj klientit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe monitorimit të zbatimit të kontratës model nga të gjithë operatorët.

Një nga praktikatat e reja në procesin e miratimit të tarifave, është përfshirja e konsumatorit, si një palë e rëndësishme në këtë proces, duke sugjeruar që dëgjuesat me komunitetin/konsumatorin të jenë pjesë e procesit të vendosjes së tarifave nga ana e operatorëve. Gjatë vitit 2013 ERRU ka vijuar procesin e monitorimit të sektorit dhe të shoqërive UK.

Publikimi i performancës nga ana e institucionit rregullator i shërben vlerësimit të krahasuar të shoqërive që operojnë në këtë sektor. Ky raport periodik është një vlerë shtesë në ecurinë e shoqërive UK, pasi rrit transparencën dhe ndikon në përmirësimin e performancës për secilën shoqëri, nëpërmjet promovimit të praktikave më të mira që evidentohen në këtë raport.

Licencat

Në zbatim të ligjit 8102 datë 23.03.1996, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij çdo subjekt që ushtron veprimtarinë e tij në furnizimin me ujë dhe kanalizime duhet të liçencohet nga ERRU.

Në sektorin ujësjellës kanalizime ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, trajtimit të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura ose një prej tyre gjithsej 58 operatorë, nga të cilët 55 janë të liçencuar.

ERRU gjatë vitit 2013 është përqëndruar jo vetëm në procesin e liçencimit, por edhe në përmirësimin e kuadrit rregullator të këtij procesi, duke miratuar në fund të vitit 2013 edhe kushtet e liçencës, si pjesë përbërëse e liçencës. Këto kushte përbëjnë një paketë rregullash për aktivitetin e operatorëve të shërbimit dhe sanksionojnë parimet kryesore për kryerjen e një shërbimi sa më të mirë. Kushtet e liçencës do të jenë objekt i monitorimit nga ERRU.

Monitorimi i tyre do të shërbejë për vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe përmirësimit të tij, por edhe rritjen e përgjegjshmërisë nga operatorët.

Intensifikimi i punës nga rregullatori dhe ndërgjegjësimi i shoqërive për të kryer veprimtarinë e tyre brenda kuadrit rregullator pasqyrohet edhe në numrin e aplikimeve për paisje me liçencë. Përgjatë

vitit 2013 kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence 31 operatorë ujësjellës kanalizime. Procesi i licensimit ka përfunduar për 26 operatorë dhe është në vazhdim për pesë të tjerët.

Në fund të vitit 2013, dy operatorët SHA U Shkodër Fshat dhe SHA UK Malësi e Madhe u bashkuan në një shoqëri të vetme në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1094, datë 26.12.2013, ndryshim i cili u reflektua edhe në licencën e shoqërisë.

Për herë të parë gjatë këtij viti kanë aplikuar dhe janë licencuar Ndërmarrja Ujësjellës Divjakë, Komuna Bradashesh, SHA UK Libohovë dhe SHA UK Fushë-Krujë. Operatorët, SHA Ujësjellës Delvinë, SHA Ujësjellës Vlorë, dhe SHA Ujësjellës Tepelenë kanë shtuar edhe kategorinë e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, shërbim i ofruar prej shumë vitesh nga vetë njësitë e qeverisjes vendore të këtyre qyteteve. SHA UK Durrës dhe SHA UK Korçë kanë vënë në funksionim impiantet për trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura dhe janë licencuar nga ERRU për këtë shërbim.

Tarifat

ERRU i ka përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave në Metodologjinë "Për Vendosjen e Tarifave". Prej dy vitesh shoqëritë UK kanë aplikuar për miratimin e tarifave bazuar në këtë metodologji. Metodologjia krijon një lidhje direkte ndërmjet ndryshimit të tarifave dhe performancës së operatorëve në mënyrë që eficientia në ofrimin e shërbimeve në sektor të rritet. Rritja e tarifave është e kushtëzuar vetëm për operatorët që arrijnë objektivat e përcaktuara nga ERRU për treguesit kryesorë të performancës. Kryesisht tarifat që kanë aplikuar operatorët kanë ardhur në rrije, në varësi kjo edhe të nivelit të performancës së tyre. Gjate tre viteve të fundit tarifat mesatare, në shkallë vendi, për konsumatorët familjare janë rritur në masën 14% për shërbimin ujësjellës dhe 25% për shërbimin e kanalizimeve.

Në vitin 2013, pranë ERRU u paraqitën 9 kërkesa për miratim tarife:

- SHA UK Korçë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
- SHA UK Gjirokastrë, SHA UK Ersekë, SHA UK Lezhë, SHA UK Sarandë, SHA UK Lushnjë, SHA UK Fier, SHA UK Berat-Kuçovë, Ndërmarrja UK Bashkia Pukë, për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
- SHA UK Tepelenë dhe SHA UK Vlorë aplikuan për miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

Në zbatim të metodologjisë procesi i miratimit të tarifave për shoqëritë që aplikojnë për herë të parë bëhet me poqedurë të përshpejtuar nga ana e ERRU.

Vlerësimi i propozimit për ndryshimin e tarifave për secilin aplikim është bërë mbi bazën e analizës së situatës aktuale ekonomike e financiare, treguesve kryesorë të performancës, tendencës së tyre, synimeve të operatorit, si dhe kushteve specifike të operimit. ERRU nëpërmjet strukturës së miratuar të tarifave për secilën shoqëri ka synuar arritjen e objektivave të politikës tarifore për mbulimin e kostos së operimit dhe mirëmbajtjes, për të bërë të mundur që gradualisht të arrihet mbulimi i kostos totale. Mbulimi i kostove nuk mund arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përpjekjet sistematike të operatorëve për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik. Eksperiencia e deritanishme në miratimin e tarifave ka treguar se ka vend për përmirësime të mëtejshme. Konsumatorët duhet të paguajnë për çdo shërbim të ofruar kostot e tij. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan analiza e kostos sipas qendrave të kostos si dhe hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve. ERRU është duke punuar për hartimin e udhëzuesve përkatës. Në të ardhmen ERRU do të kërkojë shoqërive UK të mbështesin kërkesën e tyre për ndryshimin e tarifave mbi bazën e këtyre analizave.

Për shumë operatorë kostot e shërbimit janë rritur ndjeshëm për arsye të kredive të marra dhe kostove të reja prej vënies në funksionim të impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura. Megjithëse ka vend për rritje të mëtejshme të tarifave duhet mbajtur parasysh raporti ndërmjet përballimit të tarifave nga konsumatorët dhe arritjes së pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Një pjesë e këtyre kostove mund të mbulohen përmes tarifave por mbulimi total i tyre mund të mos jetë i përballueshëm nga klientët dhe rritja e mëtejshme e tarifave mund të sjellë efekte negative sociale. ERRU është i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë çështje për të gjetur mekanizma të përshtatshëm subvencionimi për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve (shtresave në nevojë) dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

Konsumatori

Misioni i ERRU është të sigurojë për të gjithë klientët e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri shërbim me cilësinë më të mirë të mundshme dhe me një çmim të arsyeshëm. Për këtë arsye, mbrojtja e konsumatorit dhe sigurimi i një shërbimi cilësor është fokusi kryesor i punës së ERRU. Mbrojtjen e konsumatorit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj tij Enti Rregullator e realizon nëpërmjet disa instrumentave si: zbatimit të një kontrate model midis operatorëve dhe konsumatorëve; dëgjësive me publikun përpara miratimit të tarifave të reja dhe nivel tarifash të përballueshme nga shtresat në nevojë.

Zbatimi i kontratës model, si mjeti kryesor në rregullimin e marrëdhënies operator - klient është trajtuar me kujdes të veçantë nga Enti. Në monitorimin e procesit të zbatimit të kontratës model, i'u kushtua vëmendje veçanërisht nxitjes së shoqërive për përfundimin brenda afatit të lidhjes së kontratave.

Sipas detyrimit të vendosur nga Enti Rregullator deri në fund të vitit 2013 të gjitha shoqëritë duhet të përfundonin zbatimin e kontratës model me të gjithë klientet e tyre. Krahësuar me një vit më parë, janë bërë përparime, por ende nuk është arritur objektivi për përfundimin e procesit. Për vitin 2013 u arrit zbatimi i kontratës model në masën 34% për klientët familjar, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe në totalin e klientëve. Për klientët privatë kjo shifër arriti në 45% dhe për klientët publikë u arrit zbatimi në masën 81%. Duke qënë që ky proces nuk arriti të përfundohej brenda afatit të përcaktuar, Enti Rregullator i Ujit është duke parë mundësi të tjera për ta bërë kontratën model, të aplikueshme për të gjithë klientët e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri. Janë ende 6 shoqëri që nuk kanë filluar procesin e zbatimit të kontratës, ku përmendim: Divjakën, Këlcyrën, Pukën Fshat, Rogozhinën dhe Rubikun.

Sa i përket transparencës gjatë procesit të ndryshimit të tarifave, seanca dëgjimore me publikun u zhvilluan edhe gjatë vitit 2013. ERRU kërkon të sigurohet që konsumatorët të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të shprehin pikëpamjet e tyre në këtë proces. ShA UK Korçë dhe SHA UK Berat – Kuçovë organizuan seancë dëgjimore me publikun për ndryshimin e tarifave.

Gjithashtu Enti Rregullator ka bërë të mundur që konsumatorët të mund ti drejtohen në mënyrë zyrtare ERRU për shqetësime apo ankesa që lidhen me shërbimin që ata marrin nga operatorët UK. Enti shërben si ndërmjetës në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, megjithë pamundësinë ligjore për të marrë vendime në këto raste.

Përsa i takon nivelit të tarifave të përballueshme nga konsumatorët, Enti në linjë me Metodologjinë “Për Vendosjen e tarifave”, e cila ndjek politikën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë që faturat për marrjen e ujit të pijshëm të mos kalojnë nivelin prej 5% të të ardhurave të familjeve në nevojë, e vlerëson kërkesën për tarifë nga operatorët duke pasur parasysh këtë politikë. Nga ana tjetër gjatë vitit 2013 rregullatori i mbështetur nga donatorë aktiv në këtë fushë po punon për vlerësimin e një skeme subvencioni për të mbështetur pikërisht familjet në nevojë në pagimin e faturave të ujit të pijshëm duke mos përkeqësuar situatën financiare të operatorëve.

Në vijim raporti në mënyrë sa më konçize do të sjellë në vëmendjen e lexuesit (politik bërësve, konsumatorëve, pronarëve dhe ofruesve të shërbimeve) mënyrën se si kanë performuar shoqëritë ujësjellës kanalizime dhe sesi është ofruar shërbimi i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura konsumatorit.



2

Ecuria në Sektorin Ujësjiellës Kanalizime gjatë vitit 2013

Në këtë pjesë të raportit jepet një pamje e përgjithshme e zhvillimeve kryesore në sektorin UK përgjatë vitit 2013, si janë arritur objektivat strategjikë të sektorit 2011-2017 si dhe ato të vendosur nga Enti Rregullator].

Zhvillimet kryesore

Enti Rregullator i Ujit edhe gjatë vitit 2013 ka bërë përpjekje maksimale që shërbimi i ofruar konsumatorëve nga operatorë të licencuar prej tij të jetë më cilësor.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve gjatë vitit 2013 është ofruar nga 58 operatorë. Nga këta, 32 operatorë ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, ndërsa 26 operatorë kryejnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë.

Sektori i shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor në zonën administrative të të cilit operatori ofron shërbimin. Në zbatim të vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 660 datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjiellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore”, 47 operatorë shërbimesh UK kanë kaluar pranë njësive vendore përkatëse. Problematikat që shoqëruan këtë proces, bënë që transferimi efektiv i të gjithë operatorëve pranë njësive vendore të zgjatej në kohë. Deri më tani ende nuk e kanë përfunduar procesin e transferimit pranë njësive të qeverisjes vendore vetëm operatorët “U Rubik” sh.a, dhe Ndërmarrja “U Gjirokastër Fshat”.

Nga 58 operatorët në sektor vetëm 32 prej tyre i ofrojnë të dyja shërbimet (furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet). Kjo do të thotë se shërbimi i kanalizimeve kryhet nga njësitë vendore nëpërmjet sektorëve të cilat janë pjesë e strukturës së brendëshme të Bashkisë.

Ky fragmentarizim i shërbimeve nuk i shërben cilësisë së shërbimit dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve ujësjiellës. Për këto arsye, ERRU në fillim të vitit 2013 kërkoi nga njësitë e mësipërme të realizonin bashkimin e të dy shërbimeve dhe ofrimin e tyre nga operatorët e ujësjiellës që operojnë në zonën administrative të njësisë. Deri më tani 5 njësi vendore, Bashkia Orikum, Peshkopi, Delvinë, Vlorë dhe Bilisht, nëpërmjet vendimarrjes përkatëse në Këshillat Bashkiakë, transferuan shërbimin e kanalizimit pranë operatorëve të ujësjiellësve në zonë. Këtyre Bashkive ju shtohet edhe Bashkia Tepelenë e cila e ka transferuar këtë shërbim pranë operatorit të ujësjiellës në fund të vitit 2012. Ndërkohë janë në proces gjatë vitit 2014 për bashkimin e të dy shërbimeve Bashkia Patos dhe Përmet.

Është vënë re se administrata dhe përfaqësuesit e bashkive nuk e njohin kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrimin për një shërbim të licencuar dhe me standarte. Njësitë vendore kufizohen në detyrimin ligjor për të ofruar shërbimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, duke anashkaluar gjithë kuadrin ligjor në këtë drejtim i cili parashikon mënyrat sesi ofrohen këto shërbime dhe detyrimet për licencim të aktivitetit dhe miratim të tarifave për shërbimet përkatëse.

Në disa raste vihet re edhe mungesa e dëshirës për bashkimin e këtyre shërbimeve, pasi kalimi i shërbimit të kanalizimeve tek operatorët mendohet si heqje e kompetencave të tyre. Në disa raste të tjera, operatorët e shërbimit të furnizimit me ujë kanë probleme financiare dhe bashkimi i shërbimeve mund të rezultojë në shtimin e problemeve të tyre.

Për popullsinë jashtë zonave të juridiksionit të operatorëve, shërbimi ofrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive që nuk janë të licencuar nga ERRU.

Në Nëntor të vitit 2013, Enti Rregullator i Ujit filloi një studim kombëtar mbi të gjitha zonat e pambuluara me shërbim ujësjellës kanalizimesh të licencuar. Këto zona përfshijnë kryesisht njësi të vogla të qeverisjes vendore (132 komuna dhe 3 bashki) të cilat e ofrojnë vetë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonën e tyre të juridiksionit. Më konkretisht ky studim përfshin evidentimin e saktë të zonave të pambuluara me shërbim të licencuar, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e një sërë të dhënash teknike, financiare dhe menaxheriale në lidhje me shërbimin që ato ofrojnë. Rezultatet e studimit që do të përfundojnë brenda vitit 2014 do të shërbejnë për të arritur në konkluzione dhe rekomandime konkrete për rregullimin e shërbimit ujësjellës kanalizime të ofruar në këto zona. Për rrjedhojë të problematikës në këtë sektor Enti do të vazhdojë me të njëjtin intensitet trajtimin e kësaj çështje edhe gjatë vitit 2014.

Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja. Një vend të rëndësishëm zënë investimet për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Burimi kryesor i investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. Mirëmbajtja e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë zënë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos, prandaj edhe sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e tyre merr një rëndësi të veçantë.

Burimi kryesor i të ardhurave për operatorët janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët.

Edhe gjatë vitit 2013 qeveria ka akorduar subvencione por krahasuar me vitin e mëparshëm ka ulje të tyre. Ky është një sinjal që operatorët duhet të sigurojnë pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhurat për përballimin e shpenzimeve.

Performanca e përgjithshme e sektorit

Viti 2013 në përgjithësi sjell përmirësime në treguesit kyç të performancës së sektorit. Tabela 1 më poshtë jep në mënyrë të detajuar të dhënat gjatë tre viteve të fundit e 10 treguesve kryesorë të performancës për gjithë sektorin dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin 2012, me objektivat e paraqitura në strategjinë kombëtare të sektorit për vitin 2013 si dhe nivelet e objektivave për arritjen e një performace të mirë të vendosura nga ERRU.

Treguesit e performancës	2011	2012	2013	Tendenca e Performacës	Objektivat e Performacës së Mirë të ERRU	Objektivat e Strategjisë së Sektorit për vitin 2013
Mbulimi i Furnizimit me Ujë	80.8%	80.8%	80.8%	=	n/a	n/a
Mbulimi me Kanalizime	50.8%	51.0%	51.0%	=	75%	n/a
Cilësia e Ujit të Pijshëm	n/a	n/a	n/a	n/a	98%	n/a
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	10.9	10.8	11.5	↗	18	14
Mbulimi i Kostos Totale	79.4%	82.7%	84.6%	↗	80%	72%
Mbulimi i Kostove O&M	105.2%	106.3%	113.8%	↗	100%	100%
Norma e Arkëtimit	79.9%	90.9%	82.0%	↘	82%	90%
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje)	9.3	9.3	9.5	↗	4/6/10	n/a
Uji pa të Ardhura	63.5%	67.1%	67.4%	↘	30%	54%
Niveli i Matjes	50.6%	55.1%	59.0%	↗	85%	60%

Tabela 1. Përmbledhje e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizime për vitin 2013 Burimi informacionit: ERRU

Në vitin 2013, përveç mbulimit me shërbime ujë i pijshëm dhe kanalizime që kanë mbetur në të njëjtat nivele dhe normës së arkëtimit dhe ujit pa të ardhura që janë përkeqësuar ndjeshëm kundrejt vitit 2012, të gjithë treguesit e tjerë të performancës kanë shënuar rritje të lehtë. Ndër treguesit me ecurinë më të mirë gjatë vitit 2013 është ai i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes që ka arritur nivelin 113%.

Shërbimi i furnizimit me ujë i ofrohet rreth 81% të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit të operatorëve, ndërsa shërbimin me kanalizime e përfiton 51.0% e kësaj popullsie. Objektivi i strategjisë për mbulimin me këto shërbime nuk detajohet në vite, deri në fund të vitit 2017 synohet që të ketë shërbim çdo banor. Nga ana tjetër objektivat e qeverisë gjithnjë kanë pasur në fokus mbulimin me shërbim ujë të pijshëm 24 orë për zonën bregdetare dhe atë turistike. Për tre vitet e fundit radhazi asgjë nuk ka ndryshuar në këtë drejtim, operatorët mbulojnë të njëjtën popullsi me shërbimet përkatëse. Fakt është që popullsia që jeton në zonat urbane ka më shumë akses në këto dy shërbime se sa ajo që jeton në zonat rurale.

Shërbimi me kanalizime i ofrohet kryesisht popullsisë në zonat urbane të vendit ndërsa popullsia në zonat rurale pothuajse nuk e përfiton këtë shërbim. Shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë në shumë aspekte. Megjithatë, të dhënat tregojnë se në vitin 2013 ky shërbim ka patur tendencë pozitive. Numri i shoqërive që i ofrojnë konsumatorëve të dy shërbimet është rritur, nga 28 operatorë në vitin 2012 në 32 në fund të vitit 2013. Cilësia e shërbimit me kanalizime dhe mbrojtja e mjedisit është përmirësuar si rezultat i vënies në punë të 5 impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura (në fund të vitit 2012 operonin vetëm 4 të tillë). Ndërkohë të tjerë impiante janë në ndërtim e në projektim.

¹ Treguesi mbulimi i kostove totale në vitin 2013 merr në konsideratë edhe të ardhurat e tjera si: nga lidhjet e reja, tarifa e shërbimit, rilidhjet etj.

² Edhe ky tregues është rillogaritur duke marrë parasysh të njëjtat të ardhura të tjera sikurse citohet tek mbulimi i kostove totale.

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar shërbimin e largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një pjesë të madhe të vendit, si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit.

Mbulimi i kostove O&M dhe kostove totale për sektorin janë tregues me rezultat të mirë dhe tendenca e tyre ka qenë pozitive. Numri i operatorëve që kanë arritur të mbulojnë deri në 100% të kostove O&M ka ardhur duke u rritur. Kjo ka bërë që sektori të tejkalojë objektivat e qeverisë si dhe objektivat për performancë të mirë të vendosur nga ERRU në mbulimin i kostove O&M. Përgjithësisht janë operatorët e mëdhenj ata që e kanë arritur këtë rezultat, ndërsa operatorët e vegjël janë ende larg mbulimit të kostove totale. Për disa prej tyre, të ardhurat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar as gjysmën e kostove të shërbimeve. Një mundësi për të tejkaluar këtë situatë nga këto shoqëri do të ishte bashkimi i tyre me shoqëri më të mëdha.

Gjatë tre viteve të fundit niveli i mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti ka shënuar progres. Raporti ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve është përmirësuar. Rritja e tarifave për 13 operatorë në vitin 2012 dhe 10 operatorë në vitin 2013 ka ndikuar në rritjen e të ardhurave por nga ana tjetër edhe shoqëritë janë përpjekur për të mbajtur nën kontroll nivelin e shpenzimeve.

Por ndonëse rezultatet e mbulimit të kostove me të ardhura janë të mira, për normën e arkëtimit si treguesi kryesor që lidhet me pavarësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve nuk mund të themi të njëjtën gjë. Deri në vitin 2012 ky tregues ka njohur tendencë pozitive, ndërkohë që në vitin 2013 mbledhja e të ardhurave nga operatorët ka rënë. Sektori nuk ka mundur të arkëtojë më shumë se 82% të të ardhurave të realizuara, nga 90% që ka qenë në vitin 2012. Për vitin 2013 ky tregues ka arritur nivelin e objektivit për performancë të mirë të vendosur nga ERRU, por jo nivelin e objektivit strategjik të qeverisë.

Për pjesën më të madhe të shoqërive niveli i arkëtimit në vitin 2013 është ulur krahasuar me një vit më parë. Në thelb norma e arkëtimit është një aspekt menaxherial dhe niveli i arritur për këtë tregues shpreh qartë punën e vetë shoqërive. Kjo situatë duhet të tejkalohet, pavarësisht arsyeve objektive dhe subjektive.

Një tregues që merr vlerësime pozitive është niveli i matjes. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive. Niveli i këtij treguesi po rritet nga një vit në tjetrin. Në vitin 2013 rezulton se 59% e konsumatorëve në sektor janë të pajisur me matës. Krahasuar me vitin 2012 niveli i matjes në vitin 2013 është rritur 9%. Niveli i matjes së prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit i ndihmon shoqëritë të operojnë me të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e prodhuar, faturuar dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga ky faturim. Megjithatë niveli i arritur i këtij treguesi është afër nivelit 60% të objektivit të strategjisë kombëtare në këtë sektor, ai është larg nivelit 85% të objektivit për performancë të mirë të vendosur nga ERRU. Për ERRU, eliminimi i praktikës së faturimit aforfe që momentalisht mbetet në nivele të larta dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësve për konsumatorët dhe për prodhimin duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve.

Kjo praktikë do të ndihmojë gjithashtu edhe në përmirësimin e treguesit “uji pa të ardhura”, i cili në ndryshim nga treguesi i mësipërm mbetet në nivele të papranueshme për një menaxhim efektiv të shoqërisë dhe rritje të cilësisë së shërbimeve. Problematike mbetet tendenca e këtij treguesi e cila edhe pse ka njohur një përmirësim krahasuar me dy vitet e fundit ajo ka njohur një rritje fare modeste. Pjesa më e madhe e ujit të prodhuar, 67.4% e tij, nuk gjeneron të ardhura. Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohë dhe investime, ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve.

Gjatë vitit 2013, ERRU ka punuar për të marrë më shumë informacion jo vetëm në lidhje me sasinë e ujit të “humbur” por edhe për llojin e këtyre humbjeve. Për këtë arsye ka kërkuar që operatorët të plotësojnë “Bilancin e ujit” si një format i cili jep të dhëna të detajuara në lidhje me sasinë e ujit të prodhuar, faturuar, nivelin e humbjeve dhe shkaqet e tyre. Analiza e këtyre të dhënave do të shërbeje

si rregullatorit ashtu edhe shoqërive për vlerësimin e situatës dhe programimin e masave që duhet të merren për përmirësimin e saj. ERRU do ta vazhdojë këtë praktikë të filluar në vitin 2013. Në të ardhmen të dhënat e raportuara do të jenë objekt i inspektimit dhe verifikimit sidomos në ato shoqëri ku konstatohen pasaktësi dhe mospërputhje në raportim.

Efiçenca e stafit është tregues i cili nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar, megjithatë tendenca e tij nuk ka qenë pozitive. Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje në sektor është rritur nga 9.3 në vitin 2012 në 9.5 në vitin 2013. Niveli i këtij treguesi është i lartë nëse do ta krahasojmë atë edhe me vendet e rajonit. Megjithatë ka edhe operatorë ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore. Këto shoqëri janë të pakta në numër. Për pjesën më të madhe të shoqërive efiçenca e stafit është e ulët. Më shqetësuese është situata në ato shoqëri që megjithëse kanë nivel të ulët të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin 2013 kanë rritur pa ndonjë shkak të arsyeshëm numrin e punonjësve. Duke qenë se shpenzimet për paga dhe sigurime zënë një peshë të rëndësishme në totalin e shpenzimeve të shoqërisë kërkohet më shumë vëmendje nga ana operatorëve në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi (zvogëlimit të numrit të punonjësve për 1000 lidhje).

Vazhdimësia e shërbimit dhe cilësia e ujit të pijshëm janë treguesit kryesorë për vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve. Mesatarja e orëve të furnizimit për vitin 2013 është 11.5 orë në ditë. Krahasuar me një vit më parë ajo është rritur me 0.7 orë, por krahasuar me nivelet e performancës së mirë të përcaktuar nga ERRU dhe objektivit të strategjisë për këtë tregues, rezultati i arritur nuk është i kënaqshëm. Pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë të pijshëm. Vetëm SHA UK Korçë, SHA UK Pogradec dhe SHA UK Librazhd furnizojnë në mënyrë të pandërprerë klientët me ujë të pijshëm. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit.

Cilësia e ujit të pijshëm kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga Instituti i Shëndetit Publik i cili është edhe institucioni përgjegjës për monitorimin e saj. Vlerësimi i cilësisë së ujit të pijshëm nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) bëhet kryesisht mbi numrin e pikave të ndotura të matura në zonat urbane dhe niveleve të klorit mbetës dhe koliformit. Ndërkohë që vetë operatorët i raportojnë të dhënat në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm çdo muaj pranë DPUK.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Për këtë arsye bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për cilësinë e ujit të pijshëm është forcuar gjatë vitit 2013. ERRU ka konstatuar se ka vend për rregullime si përsa i përket pasaktësive që lidhen me procedurat aktuale të monitorimit dhe cilësinë e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në këtë kuadër, ERRU me mbështetjen GIZ, në bashkëpunim me ISHP dhe Ministrinë e Shëndetësisë kanë realizuar një vlerësim të standarteve kombëtare për cilësinë e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, procedurave të monitorimit të tyre dhe kushteve dhe stafeve për të siguruar një cilësi të ujit të pijshëm brenda standardeve kombëtare. Në përfundim të këtij vlerësimi është arritur në konkluzionin se: (i) ka ndryshime në mënyrën e monitorimit të standarteve të ujit të pijshëm nga operatorët UK dhe ISHP; (ii) të dhënat e DPUK bazohen mbi vetëdeklarimin e operatorëve (kur këta të fundit vetëm 10 prej tyre kanë laboratore dhe vlerësojnë cilësinë e ujit vetëm në prodhim) ndërkohë që ISHP verifikon dy herë në ditë klorin dhe një herë në ditë koliformin në rrjetet shërndarëse sipas pikave të përcaktuara; (iii) diferencë e theksuar në rezultatet e cilësisë së ujit të pijshëm ku ISHP vlerëson se vetëm 4 operatorë kanë normë sigurie të klorit mbetës mbi 95% ndërkohë që për DPUK janë 47 operatorë brenda kësaj norme sigurie. Për normën e sigurisë së koliformit ISHP vlerëson 39 operatorë me një nivel mbi 95%, ndërsa DPUK 47 operatorë. Nga kjo analizë del emergjente nevoja për të forcuar procedurat që garantojnë një cilësi të ujit të pijshëm brenda standarteve kombëtare. Një raport i detajuar në lidhje me masat konkrete që duhet të ndërmerren në këtë drejtim do të diskutohet dhe shpërndalet me operatorët gjatë vitit 2014.



Konsumimi me Ujë (litra/klient)	n/a	n/a	11.5
Konsumimi me Ujë (litra/klient)	10.9	10.8	11.5
Konsumimi Total	79.4%	82.7%	84.6%
Konsumimi O&M	105.2%	106.3%	113.8%
Konsumimi	79.9%	90.9%	82.0%
Konsumimi Total (litra)	9.3	9.3	9.5



3 | Analiza e performancës për shoqëritë ujësjellës kanalizime

Në këtë pjesë të raportit analizohet dhe vlerësohet performanca individuale e shoqërive ujësjellës kanalizime për vitin 2013 si dhe ecuria e tyre që nga viti 2011. Metoda e përdorur për vlerësim bazohet në 10 treguesit kryesorë të performancës. Në vijim secili prej tyre është përshkruar shkurtimisht.

Treguesit kryesorë të performancës

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime bazohet në 10 tregues kryesorë të performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimit më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve. Këta tregues janë:

TKP	Përshkrimi
1 – Mbulimi i Kostove O&M	Pjesa e kostove operative dhe mirëmbajtjes (përfshijë amortizimin dhe kostot kapitale) që mbulohen nga të ardhurat.
2 – Mbulimi i Kostos Totale	Pjesa e kostove totale për shërbimet e ofruara që mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë.
3 – Norma e Arkëtimit	Raporti ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së faturuar ndaj klientëve.
4 – Efienca e Stafit	Numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje.
5 – Uji pa të Ardhura	Pjesa e ujit të prodhuar që nuk i faturohet klientëve.
6 – Niveli i Matjes	Pjesa e lidhjeve me matës (numri i klientëve) si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të lidhjeve (klientëve).
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	Orët mesatare të furnizimit me ujë në ditë.
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm	Pjesa e testeve për cilësinë e ujit të cilat përmbushin standardet bakteriologjike (koliforme) dhe ato të klorit mbetës.
9 – Mbulimi me Kanalizime	Pjesa e popullsisë brenda zonës së shërbimit të një shoqërie të cilës i ofrohet shërbim kanalizimi, por jo domosdoshmërisht trajtimi i ujërave të ndotura.
10 – Perceptimi Rregullator	Është vlerësimi i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kuadrin rregullator.

Tabela 2. Pasqyra e treguesve kryesorë të performancës 2013

Nisur nga objektivi i ERRU për të patur një sektor financiarisht të qëndrueshëm i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët, treguesit e performancës që vlerësojnë çdo shoqëri më vete dhe sektorin në përgjithësi janë përzgjedhur të tillë që të vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe performancën e shërbimit tek konsumatorët. Në këtë kuptim kemi analizuar fillimisht performancën individuale të çdo shoqërie e më pas janë krahasuar nivelet e arritura ndërmjet shoqërive, duke identifikuar performuesit më të mirë dhe praktikatat më të mira në vend.

Niveli i treguesve të performancës nxjerr në pah efektet e faktorëve të brendshëm si përmirësimi i menaxhimit por edhe efektin e faktorëve të jashtëm si investimet nga Qeverisja Qendrore, grantet e donatorëve etj. Nivelet e arritura të treguesve si niveli i matjes apo mbulimi me shërbimet e kanalizimeve nuk varen vetëm nga puna e ofruesve të shërbimit, pasi për të rritur nivelin e tyre kërkohen investime kapitale. Por, shumë tregues të tjerë si norma e arkëtimit, eficientia e stafit, uji pa të ardhura si dhe mbulimi i kostove varen drejtpërsëdrejti nga puna e shoqërive. Përpjekjet e brendshme të shoqërive luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e tyre.

Perceptimi rregullator është një tregues tjetër i analizës, përmes të cilit vlerësohet bashkëpunimi i shoqërive në procesin rregullator duke mbështetur përpjekjet e ERRU për të krijuar një mjedis rregullator transparent dhe të qëndrueshëm.

Analiza e performancës: Grupet e shoqërive

Në mënyrë që vlerësimi krahasues i performancës ndërmjet shoqërive të jetë sa më real, ERRU ka vendosur që shoqëritë ujësjellës kanalizime të grupohen sipas numrit të lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, si një mënyrë e mirë për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha apo të vogla.

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës	11
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	18
Grupi 2	< 3,000 lidhje ujësjellës	29 ³

Tabela 3: Grupi i shoqërive Burimi informacionit: ERRU

Shënim: Sha UK Himare, Sha U Novosele, Sha U Bradashesh nuk kanë raportuar të dhëna. Numri i shoqërive të analizuar në këtë grup është 26.

Në tabelën e mëposhtëme është pasqyruar ndarja e 58 shoqërive sipas grupeve.

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve Konsumatore (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve Konsumatore (ujësjellës)
GRUPI 1			GRUPI 3		
UK	Tiranë	176,122	UK	Peqin	2,884
UK	Durrës	73,044	UK	Himarë	2,807
UK	Vlorë	41,268	U	Divjakë	2,786
UK	Elber sh.p.k	30,229	U	Ura Vajguore	2,710
UK	Fier	28,404	U	Bulqizë	2,684
UK	Shkodër	27,165	U	Bilisht	2,546
UK	Berat - Kuçovë	25,037	UK	Delvinë	2,366
UK	Kavajë	22,953	U	Novoselë	2,314
UK	Korçë	20,832	U	Shkodër Fshat	2,287
U	Elbasan Fshat	17,330	UK	Fushë Krujë	2,150
UK	Sarandë	16,218	U	Malsi e Madhe	2,093
GRUPI 2			U	Orikum	1,898
UK	Pogradec	14,106	U	Corovodë	1,761
UK	Lushnjë	10,716	UK	Ersekë	1,664
UK	Gjirokastër	9,238	U	Polican	1,600
UK	Lezhë	7,478	U	Tropojë	1,516
U	Korçë Fshat	5,988	U	Selenicë	1,506
U	Lushnjë Fshat	5,835	U	Has	1,361
U	Kurbini	5,742	UK	Mirditë	1,200
UK	Kukës	4,973	UK	Bashkia Pukë	1,117
UK	Librazhd	4,780	U	Këlcyrë	1,002
U	Patos	4,652	U	Vau i Dejës	911
UK	Rrogozhinë	4,128	UK	Libohovë	783
UK	Burrel	4,080	UK	Fushë Arrëz	560
UK	Mallakastër	4,012	UK	Rubik	534
U	Gramsh	3,949	UK	Pukë Fshat	523
UK	Krujë	3,574	UK	Krastë	413
UK	Tepelenë	3,537	U	Gjirokastër Fshat	132
UK	Peshkopi	3,426	U	Bradashesh	1
U	Përmet	3,287			

Tabela 4: Ndarja e shoqërive në tre grupe Burimi i informacionit ERRU

Analiza e performancës në lidhje me objektivat e vendosur nga ERRU

Përfekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhet arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performancë të mirë; gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën 5 tregohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa grafiku 1 më poshtë është një shëmbull i grafikëve të analizës së TPK.




Figura 1. Shëmbulli i Grafikëve të analizës së TPK-ve

Treguesit kryesorë të Performancës		Objektivat e vendosur		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efiçenca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje)	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤ 8 orë/ditë
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm		≥ 95%	90 - 95%	≤ 90%
9 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%
10 – Perceptimi Rregullatorit		n/a	n/a	n/a

Tabela 5. Analiza e Objektivave të vendosur për treguesit kryesorë të performancës

Renditja e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime

Në këtë pjesë është vlerësuar performanca e përgjithshme të secilës prej shoqërive bazuar në vlerësimin e 8 nga 10 TKP-të. Për të bërë krahasimin e shoqërive ujësjiellës kanalizime, renditja e tyre bazohet në shumën totale të pikëve të grumbulluar nga analiza e detajuar e secilit TPK.

Çdo treguesi i është caktuar një peshë specifike dhe pikët e dhëna pasqyrojnë performancën e shoqërisë kundrejt niveleve të objektivave të vendosura nga ERRU.

Performancës baraz ose mbi nivelin e objektivit të synuar që është vendosur nga ERRU i jepen pikët maksimale. Për shumicën e treguesve, kur performanca është nën objektivin e synuar për performancë të mirë shoqëria vlerësohet vetëm me një pjesë të pikëve të përcaktuara. Për treguesit si efiçenca e stafit, uji pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm, performanca e dobët penalizohet rëndë duke mos i dhënë asnjë pikë. Në këtë rast, vlerësimi me pikë bëhet nëse performanca aktuale është brenda kufirit të performancës së pranueshme.

3.1 Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes

Treguesi “Mbulimi i kostove O&M” është një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie. Ky tregues pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës (pa amortizimin). Në vitin 2013, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 113.8%. Sektori ka tejkaluar objektivin strategjik të qeverisë si dhe nivelin e objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë në lidhje me këtë tregues që në vitin 2011, kur mesatarja e sektorit në mbulimin e këtyre kostove arriti në nivelin 100.6%. Gjatë tre viteve të fundit sektori ka bërë progres në mbulimin e këtyre kostove. Në krahasim me vitin 2011 mbulimi i kostove të O&M në vitin 2013 është rritur 11.7%, ndërsa krahasuar me një vit më parë rritja është 7.1%.

Grupi i parë i shoqërive

Rezultatet e mësipërme tregojnë se pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi kanë arritur ti mbulojnë tërësisht kostot operative dhe mirëmbajtjes (O&M). Në grupin e parë, niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 7 shoqëri, SHA UK Tiranë, SHA UK Korçë, SHA UK Berat-Kuçovë, Elber SHPK, ShA UK Fier, SHA UK Shkodër dhe ShA UK Sarandë. Për vitin 2013, në grupin e parë shoqëria me performancën më të mirë është ShA UK Tiranë ku mbulimi i kostove të O&M është në nivelin 181.1%, ndërsa shoqëria me performancën më të dobët është SHA U Elbasan Fshat, ku mbulimi i kostove O&M është 65.1%. Në kufijtë e performancës së dobët, poshtë vijës së kuqe, vazhdon të funksionojnë edhe SHA UK Durrës me 67.1% të mbulimit të kostove të O&M. Rezultatet e arritura në mbulimin e kostove të O&M nga ShA UK Vlorë 97% dhe ShA UK Kavajë 94.2% i kanë renditur këto shoqëri në brezin e performancës së pranueshme.




Figura 2. Mbulimi i kostove O&M për grupin 1 në vitin 2013

Krahasimi i niveleve të arritura në mbulimin e kostove O&M në vitin 2013 me ato të një viti më parë tregon se tendenca e këtij treguesi përgjithësisht ka qënë pozitive. Për 7 nga 11 shoqëritë e këtij grupi niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes është rritur. Progresi më i madh është shënuar nga SHA UK Fier me (42.4%). Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë arritur edhe ShA UK Berat Kuçovë me 27.4% dhe SHA UK Vlorë me 24.2%. Progres është shënuar edhe nga SHA UK Shkodër me 15.3%, SHA UK Tiranë me 10%, SHA UK Korçë me 8.1% dhe SHA UK Sarandë me 5%. Mbulimi i kostove O&M nga të ardhurat është përkeqësuar për SHA UK Elber që regjistron edhe tendencën më të madhe në rënie (-11.2%) e ndjekur nga SHA UK Durrës (-7.8%), SHA U Elbasan Fshat (-6.3%) dhe SHA UK Kavajë (-4.2%).

Rezultatet pozitive të arritura nga shoqëritë e këtij grupi për vitin 2013, si në nivelin e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes dhe progresin e këtij treguesi janë rezultat i përmirësimit të raportit ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Ato shoqëri që kanë treguar kujdes për të mbajtur në kontroll nivelin e shpenzimeve dhe nga ana tjetër kanë rritur nivelin e të ardhurave si rezultat i rritjes të nivelit të faturimit dhe ndryshimit të tarifave kanë arritur edhe rezultatet më pozitive.

Grupi i dytë i shoqërive:

Në vitin 2013, numri i shoqërive që dallohen për performancë të mirë në mbulimin e kostove O&M në këtë grup është rritur krahasuar me vitin 2012. Nga 6 shoqëri që mbulonin 100% të kostove të O&M në vitin 2012, SHA UK Gjirokastrë, SHA UK Pogradec, SHA U Peshkopi, SHA UK Librazhd, SHA U Gramsh dhe SHA UK Krujë, në vitin 2013 mbulimi i këtyre kostove është bërë i mundur edhe nga dy shoqëri të tjera : ShA UK Lezhë dhe SHA UK Burrel.

Nivelin më të mirë të këtij treguesi e ka arritur SHA UK Pogradec me 180.1%. Edhe për këtë vit SHA U Patos vazhdon të jetë shoqëria me performancën më të dobët. Niveli i mbulimit të kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti është vetëm 25.6%. Nën kufirin e performancës së dobët 80% renditen edhe shtatë shoqëri të tjera: SHA U Tepelenë me 70.0%, SHA U Lushnjë Fshat me 55.7%, UK Rrogozhinë me 55.3%, SHA U Kurbin me 51.2% SHA UK Mallakastër me 43.6% dhe SHA U Korçë Fshat me 40.6%.

Për vitin 2013, SHA UK Pogradec dallon në këtë grup jo vetëm për nivelin më të mirë të arritur në mbulimin e kostove të O&M por edhe për progresin më të mirë. Përmirësimi i këtij treguesi është 50.5% kundrejt një viti më parë. ShA UK Pogradec është një eksperiencë pozitive në menaxhimin e aktivitetit dhe kryerjen e shërbimit si dhe në aplikimin e sistemit tarifor me blloqe, i cili ka bërë të mundur rritjen e të ardhurave. Që nga viti 2011 ShA UK Pogradec zbaton tarifa me dy pjesë, tarifë fikse dhe variabël me dy blloqe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve.




Figura 3. Mbuli i kostove O&M për grupin 2 në vitin 2013

Gjithashtu përmirësim të mirë në mbulimin e kostove O&M krahasuar me një vit më parë kanë arritur edhe SHA UK Burrel me 38.7%, SHA UK Lezhë me 30.6%. Progres ky tregues ka patur edhe për ShA UK Krujë, ShA UK Librazhd, ShA UK Përmet, ShA UK Lushnje, ShA UK Kukës ShA UK Rrogozhinë, ShA UKorçë Fshat e ShA U Patos. Rritja e shkallës së mbulimit të kostove të O&M me të ardhurat

nga aktiviteti për këto shoqëri varion nga 2%-10%. Këto shoqëri kanë bërë përpjekje konstante për të përmirësuar situatën e tyre financiare.

Tendencë negative ky tregues ka patur për SHA U Lushnje Fshat, që ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove O&M, me (-20.7.8%), SHA UK Gjirokastër me (-11.5%), SHA UK Tepelenë me (-6.5%), SHA UK Peshkopi me (-2.1%), SHA UK Mallakastër me (-1.83%) dhe SHA UK Gramsh me (-3.2%).

Grupi i tretë i shoqërive:

Në këtë grup, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht kostot O&M është arritur vetëm nga tre shoqëri : ShA U Malësi e Madhe, ShA UK Ersekë dhe ShA U Delvinë.

Nga 26 shoqëritë e marra në analizë në këtë grup, 20 prej tyre renditen nën vijën e kuqe, pra në brezin e performancës së dobët. Rezultatet tregojnë se 11 shoqëri nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove O&M. Performanca më e mirë e këtij treguesi është arritur nga SHA U Malësi e Madhe me 161.9%, dhe shoqëria me performancën më të dobët është SHA U Gjirokastër Fshat, që mbulon vetëm 24.2% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

Megjithëse niveli i mbulimit të kostove të O&M për pjesën më të madhe të shoqërive të këtij grupi nuk është i mirë, krahasuar me një vit më parë ky tregues ka ecuri pozitive për 21 nga 26 shoqëritë e analizuar. Niveli i mbulimit të këtyre kostove me të ardhurat e realizuara ka ardhur duke u rritur. Rritja më e madhe është shënuar nga SHA U Ura Vajgurore me 34.7%. Ndërmjet pesë shoqërive që kanë përkeqësuar këtë tregues, ShA U Malësi e Madhe ka rregjistruar rënien më të madhe me (-22.5%) të nivelit të mbulimit të kostove O&M. Megjithatë kjo shoqëri i mbulon shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes me të ardhurat e saj.




Figura 4. Mbulimi i kostove O&M për grupin 3 në vitin 2013

Rezultatet e analizës së mësipërme tregojnë se situata gjatë këtyre tre viteve ka ndryshuar për këtë grup. Krahasuar me vitin 2011, shoqëritë e këtij grupi kanë përmirësuar mbulimin e kostove O&M me të ardhura. Në vitin 2011 asnjë shoqëri e këtij grupi nuk kishte arritur të vlerësohej për performancë të mirë dhe vetëm tre shoqëri kishin arritur një nivel të pranueshëm të performancës. Në vitin 2013, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është arritur nga tre shoqëri, dhe tre të tjera renditen në brezin e performancës së pranueshme. Krahasuar me vitin 2011 edhe për 15 shoqëri të tjera ky tregues ka patur progres. Mbulimi i kostove O&M është përkeqësuar vetëm për katër shoqëri: ShA UK Divjakë me (-10.8%), ShA U Gjirokastrë Fshat me (-9.2%), ShA UK Fushë Arrëz me (-1.2%) dhe ShA U Këlcyrë me (-1.6%). Ky përkeqësim është kryesisht rezultat i nivelit të ulët të të ardhurave.

Përfundime.

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se shoqëritë UK kanë bërë përpjekje për rritur nivelin e mbulimit të kostove O&M. Megjithatë, 29 shoqëri mbulojnë më të ardhurat e tyre më pak se 80% të kostove O&M duke u renditur kështu nën kufirin e performancës së pranueshme. Më problematik paraqitet problemi me 15 prej këtyre shoqërive që mbulojnë më pak se 50% të kostove të O&M me të ardhurat e tyre. Vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbështetet nga subvencionimi i buxhetit të shtetit. Megjithëse këto shoqëri kanë rritur nivelin e të ardhurave, vihet re se shumë zëra, si kosto e energjisë, shpenzimet për personelin që zënë edhe peshën më të madhe në totalin e kostove O&M janë rritur. Subvencioni i herëpashershëm për shlyerjen e borxheve të krijuara nga shoqëritë nuk është zgjidhja e problemit.

Vendosja e një raporti sa më të mirë ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave kërkon që shoqëritë të punojnë si për të rritur të ardhurat dhe për të ulur kostot e shërbimeve. Operatorët duhet të marrin në konsideratë të gjitha opsionet për të rritur efikasitetin operacionale në lidhje me faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave si dhe kontrollin e kostove.

Për të identifikuar pikat e nisjes për një efikasitet më të mirë, është e nevojshme të analizohen në veçanti treguesit si: uji pa të ardhura, niveli i matjes, efikasiteti i stafit dhe efikasiteti i energjisë. Ulja e nivelit të humbjeve, reduktimi i stafit të tepërt dhe rritja e efikasitetit në punë do të thotë ulje e shpenzimeve jo efektive. Nga ana tjetër rritja e nivelit të faturimit dhe arkëtimin luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e mbulimit të kostove O&M.

ERRU e konsideron mbulimin tërësor të kostove O&M nga shoqëritë, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer. Për ERRU ndarja e shpenzimeve sipas qendrave të kostos merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur krahas tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të miratojë për disa shoqëri edhe tarifën për shërbimin e trajtimit të ujrave të ndotura.

Në zbatim të Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", miratimi i rritjes së tarifave është i kushtëzuar me përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës. Në këtë mënyrë ERRU mbështet dhe stimulon ato shoqëri që bëjnë përpjekje për të përmirësuar efikasitetin operacionale dhe shërbimin ndaj klientëve.

3.2 Mbulimi i kostos totale

Mbulimi i kostos totale me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera është objektivi kryesor i çdo shoqërie. Për vitin 2013, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin është 84%. Ky tregues gjatë tre viteve të fundit ka patur ecuri pozitive. Vit pas viti niveli i mbulimit të kostos totale për shërbimet UK ka ardhur duke u rritur. Gjatë vitit 2013 niveli i mbulimit të kostove totale krahasuar me vitin 2011, është rritur 4.6%. Niveli i arritur i këtij treguesi dhe tendenca e tij tregojnë se sektori ujësjellës kanalizime është duke rritur gradualisht mbulimin e kostos totale në përputhje me objektivin strategjik të qeverisë. Në vitin 2013, objektivi strategjik (70%) dhe ai i synuar nga ERRU (80%) i këtij treguesi për sektorin është tejkaluar, që tregon një zhvillim edhe më pozitiv.

Grupi i parë i shoqërive:

Siç shihet edhe nga grafiku i mesipërm, niveli i mbulimit të kostos totale për shoqëritë e grupit të parë është i ndryshëm. Në vitin 2013, kufiri i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë (80%) është tejkaluar nga gjashtë shoqëri: SHA UK Tiranë (127.3%), SHA UK Shkodër (106.2%), SHA UK Fier (99.3%), Elber shpk (98.5%), SHA UK Berat - Kuçovë (91.3%) dhe SHA UK Korçë (86%). Në brezin e performancës së pranueshme gjenden katër shoqëri: SHA UK Durrës (62%), SHA UK Vlorë (61.3%) dhe SHA UK Elbasan Fshat dhe Sarandë (61.1%). Vetëm SHA UK Kavajë vazhdon të renditet në fund të grupit për performancë financiare shumë të dobët, me vetëm 46.6% të mbulimit të kostos totale.




Figura 5. Mbulimi i kostos totale për grupin 1 në vitin 2013

Rezultatet e arritura në mbulimin e kostos totale për secilën nga shoqëritë e këtij grupi, krahasuar me nivelet e këtij treguesi në vitin 2012, tregojnë se ky tregues nuk ka patur ecuri pozitive për të gjitha shoqëritë. Tendencën më pozitive në mbulimin e kostos totale është arritur nga SHA UK Fier me (31.7%). Përmirësime në mbulimin e kostos totale kanë patur gjithashtu SHA UK Shkodër me (11.1%), SHA UK Berat - Kuçovë me (12.3%), SHA UK Elbasan Fshat me (9.6%) dhe SHA UK Kavajë me (7.2%). Ndërsa për shoqëritë e tjera tendenca e këtij treguesi ka qenë negative. Mbulimi i kostos totale është ulur (-6.8%) për SHA UK Durrës, (-6.3%) për SHA UK Tiranë, (-5.8%) për UK Elber,sh.p.k (-1.2%) për SHA UK Korçë, (-0.84%) për SHA UK Sarandë.

Grupi i dytë i shoqërive:

Në grupin e dytë, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është tejkaluar nga 7 prej 18 shoqërive të këtij grupi, dy prej të cilave SHA UK Gjirokastrë me (113.2%) dhe SHA UK Pogradec me (111.9%) kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove totale. Gjithashtu renditen mbi nivelin prej 80% të objektivit të performancës së mirë edhe SHA UK Librazhd (91.8%), SHA U Peshkopi (91.7%), SHA U Burrel (90.9%), SHA U Lezhë (81.9%) dhe SHA U Përmet (81.5%).

Siç edhe shihet nga grafiku, SHA UK Gjirokastrë kryeson me nivelin më të lartë të mbulimit të kostove totale për vitin 2013, ndërsa SHA U Patos vazhdon të renditet e fundit në grupin e dytë me vetëm (19.6%) të mbulimit të kostove totale. Në grupin e dytë janë pesë shoqëri të cilat nuk mbulojnë as 50% të kostove totale, pra janë nën nivelin e objektivit të vendosur si performancë e dobët: SHA U Kurbin (49.4%), SHA UK Lushnjë Fshat (48.8%), SHA UK Mallakastër (39.8%), SHA UK Rrogozhinë (39.8%) dhe SHA U Korçë Fshat (36.8%).




Figura 6. Mbulimi i kostos totale për grupin 2 në vitin 2013

Gjatë vitit 2013 për pjesën më të madhe të shoqërive të këtij grupi ky tregues ka patur progres krahasuar me vitin 2012. Shoqëritë që kanë shënuar rritjen më të madhe në nivelin e mbulimit të kostove totale janë SHA UK Burrel me (27.3%), duke kryesuar si shoqëria me ecurinë më të mirë në këtë grup, e ndjekur nga Sha UK Pogradec me (20,2%).

Nga 18 shoqëri, për 6 prej tyre niveli i mbulimit të kostove totale është përkeqësuar, për SHA UK Gjirokastrë dhe SHA UK Përmet me (-8.9%), SHA UK Tepelenë (-7.9%), SHA U Lushnje Fshat (-7.7%), ndersa për SHA UK Patos, SHA UK Mallakastër ulja ka qënë më vogël, respektivisht (-2.8%) dhe (-1.6%).

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë numri i shoqërive që renditen mbi nivelin e objektivit të vendosur nga ERRU prej 80% për performancë të mirë është i vogël. Nga 26 shoqëritë e marra në analizë, vetëm tre prej tyre Sha UK Delvinë (96.6%), Ersekë (94.5%) dhe Ura Vajgurore (82.5%) e kanë arritur objektivin e vendosur nga Enti rregullator. Në kufirin e performancës së pranueshme me mbi 50% të mbulimit të kostos totale renditen 7 shoqëri. Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi, 16 prej tyre, bëjnë pjesë në brezin e performancës së dobët, pasi nuk kanë arritur të mbulojnë as 50% të kostove totale. SHA UK Gjirokastrë Fshat është shoqëria me nivelin më të ulët të mbulimit të kostos totale me (18.6%), pra edhe me performancën më të ulët.




Figura 7.Mbulimi i kostos totale për grupin 3 në vitin 2013

Krahasimi i nivelit të arritur nga operatorët në mbulimin e kostos totale me atë të vitit 2012 tregon se pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi, kanë bërë përpjekje për ta përmirësuar situatën. Për 20 prej tyre niveli i mbulimit të kostos totale është rritur. Në vitin 2013 për ecurinë më pozitive dallohet SHA U Ura Vajguore e cila ka rritur me gati 34% nivelin e mbulimit të kostove totale krahasuar me një vit më parë, e ndjekur nga SHA UK Ersekë me rreth 25%.

Gjate vitit 2013, niveli i mbulimit të kostove totale është ulur për 6 shoqëri. Krahasuar me një vit më parë, rënia më e madhe në përqindjen e mbulimit të kostove totale është shënuar nga SHA U Malësi e Madhe (70.1%). Krahasimi i rezultatit të këtij treguesi në vitin 2013 me atë të vitit 2012, dhe 2011 tregon se kjo diferencë është produkt i pasaktësive në raportimin e të dhënave nga kjo shoqëri. Për pesë shoqëritë e tjera mbulimi i kostove totale ka qenë i vogël (rreth 5%).

Në grupin e tretë bëjnë pjesë shoqëri të vogla me situatë të vështirë financiare. Pavarësisht faktorëve të jashtëm si mungesa e investimeve dhe numri i vogël i konsumatorëve në një zonë me shtrirje të madhe shërbimi vihet re mungesa e përpjekjeve për të përmirësuar nivelin e ulët të mbulimit të kostove nëpërmjet një menaxhimi më të mirë.

Shumë nga shoqëritë e këtij grupi nuk kanë aplikuar asnjëherë për ndryshim tarife e një pjesë tjetër operojnë me tarifa të vendosura përpara shumë vitesh.

Përfundime

Niveli mesatar i mbulimit të kostove totale për sektorin UK në vitin 2013, si dhe ecuria e këtij treguesi tregojnë se shoqëritë UK janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbuluar me të ardhurat e tyre kostot e shërbimeve të ofruara. Analiza e performancës tregon se rezultatet më të mira të mbulimit të kostos totale janë arritur nga shoqëritë e mëdha ujësjellës kanalizime, ndërsa shumica e shoqërive të vogla vazhdojnë të varen nga burimet e jashtme financiare.

Përqindjen më të madhe në totalin e kosto e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqëndrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve. Menaxhimi më i mirë i burimeve njerëzore, organizimi më i mirë i punës, ulja e nivelit të humbjeve janë disa nga drejtimet kryesore që bëjnë të mundur uljen e shpenzimeve të operimit dhe mirëmbajtjes, sidomos në dy zërat kryesorë; kostot e personelit dhe energjisë elektrike.

Krahas këtyre shpenzimeve edhe shpenzimet për mbulimin e amortizimit zënë një pjesë të rëndësishme në totalin e kostove. Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve do të bënte të mundur uljen e këtyre kostove. ERRU e konsideron këtë një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive prandaj është duke punuar për hartimin e një manuali që do t'ju vijë në ndihmë shoqërive UK për një menaxhim më të mirë të aktiveve fikse.

Investimet e kryera në sektorin UK kanë si burim financimi kryesisht buxhetin e shtetit, donacionet dhe kreditë. Investimet nga fondet e veta të shoqërive janë mëse modeste. Për shoqëritë të cilat burimi i financimit të investimeve janë kreditë, kosto e kredisë është shtesë në koston totale. Planet e biznesit janë një mjet i rëndësishëm për planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e investimeve, si dhe për parashikimin e kthimit nga investimet e realizuara.

Për këtë arsye Enti Rregullator do të kërkojë përgatitjen e planeve të biznesit tre vjeçare për shoqëritë e mëdha dhe ato që aplikojnë për tarifë disavjeçare.

Krahas punës për uljen e shpenzimeve një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet edhe rritjes së të ardhurave. Jo vetëm rritja e tarifave, por edhe faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të paguar për shërbimet e ofruara bëjnë të mundur rritjen e të ardhurave.

ERRU do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë të gjitha shoqëritë UK për rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve.

3.3 Norma e Arkëtimit

Norma e arkëtimit është një nga treguesit kryesorë për vlerësimin e pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK. Nëpërmjet këtij treguesi kuptojmë se sa efektive është një shoqëri për të garantuar likuiditetin e nevojshëm. Norma e arkëtimit është raporti ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së faturuar për shërbimet e ofruara. Performanca në lidhje me normën e arkëtimit në thelb është funksion menaxherial. Për vitin 2013, norma mesatare e arkëtimit në sektorin ujësjellës-kanalizime është 82% nga 90% që ka qenë në vitin 2012. Niveli i arkëtimit në vitin 2013 krahasuar me atë të vitit 2012 është ulur me 8.9%. Performanca e sektorit prej 82% për këtë tregues është në kufirin e objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë, por i është larguar objektivit strategjik të sektorit për vitin 2013 prej 90%.

Grupi i parë i shoqërive:

Në grupin e parë, shoqëria me performancën më të mirë të këtij treguesi për vitin 2013 është SHA UK Tiranë, e cila ka arritur të arkëtojë 99% të shumës së faturuar. Niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është arritur edhe nga SHA UK Korçë (89.6%) dhe SHA U Elbasan Fshat (86.9%) por gjithësesi ende nën nivelin e objektivit kombëtar (strategjia e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve 2013-2017). Shoqëria me nivelin më të ulët të arkëtimit, pra edhe me performancën më të dobët është SHA UK Shkodër (52.2%).




Figura 8. Norma e arkëtimit për grupin 1 në vitin 2013

Rezultatet e arritura për arkëtimin e të ardhurave në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012 edhe për shoqëritë e këtij grupi tregojnë se ndryshimet pozitive kanë qenë të vogla dhe janë realizuar vetëm nga tre shoqëri. Niveli më i lartë i rritjes është regjistruar nga SHA UK Sarandë me 4.9%. Për pjesën më të madhe të shoqërive, tetë nga njëmbëdhjetë shoqëri, norma e arkëtimit është ulur. Shoqëritë të cilat kanë pësuar rënie të këtij treguesi krahasuar me vitin para ardhës janë: SHA UK Fier (-24.3%), SHA UK Vlorë (-14.9%), SHA UK Tiranë (-10.5%), SHA UK Durrës (-8.2%), SHA UK Berat-Kuçovë (-6.6%), Elber SHPK (-6.2%), SHA UK Kavajë (-5.7%) dhe SHA UK Shkodër (-6.9%). Siç shihet përkeqësimi i këtij treguesi, jo vetëm është regjistruar për një numër më të madh shoqëriish të këtij grupi, por edhe ndryshimet negative janë më të mëdha se ato pozitive.

Grupi i dytë i shoqërive:

Në grupin e dytë, nivelet e arritura të normës së arkëtimin i ka renditur 7 prej 18 shoqërive të këtij grupi mbi nivelin 82%, që është objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Performanca më e mirë i përket SHA U Korçë Fshat ku norma e arkëtimit është 91.5%. Vetëm një nga shoqëritë e këtij grupi është pozicionuar nën vijën e kuqe të performancës së dobët, SHA UK Kukës me nivel të arkëtimin 55.3%.




Figura 9. Norma e arkëtimin për grupin 2 në vitin 2013

Krahasuar me vitin 2012, norma e arkëtimin për vitin 2013 për 8 shoqëri të këtij grupi ka patur tendencë pozitive. Shoqëria me ecurinë më pozitive është SHA U Kurbin me një përmirësim prej 25.1%, gjë e cila ka bërë të mundur që shoqëria të kapërcejë nivelin e performancës së dobët. Për t'u përmendur janë edhe Sha UK Burrel dhe SHA U Lushnjë Fshat me përmirësim të normës së arkëtimin respektivisht 15.1% dhe 10.6%. Norma e arkëtimin është ulur për 10 shoqëri. Shoqëria që ka regjistruar rënien më të madhe të këtij treguesi me (-14.7%) është SHA U Kukës, e ndjekur nga SHA U Lezhë me (-14.2%), SHA UK Lushnjë me (-12.9%). Sha UK Tepelenë me (-9.4%). Për SHA UK

Përmet, SHA UK Librazhd, SHA UK Gramsh, SHA UK Peshkopi, SHA UK Krujë, SHA UK Mallakastër rënia e nivelit të arkëtimit është disi më e vogël duke variuar nga 1.5% deri në 6%.

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë, 9 shoqëri kanë performancë të mirë të këtij treguesi. Norma e tyre e arkëtimit në vitin 2013 është më e madhe se 82%. Shoqëria me performancën më të mirë është SHA U Rubik me normë arkëtimi 113.5%. Ky rezultat ka ardhur si rrjedhojë e punës së mirë që është bërë për arkëtimin e debive nga periudhat e mëparshme. E njëjta situatë paraqitet edhe për SHA UK Bashkia Pukë, ku niveli i arkëtimit është 110.4%.

Por 11 shoqëri janë renditur nën vijën e kuqe të performancës, vlerësuar me një tregues të dobët. Arkëtimi i të ardhurave nga faturimi është më pak se 60%. Shoqëria me performancën më të dobët vazhdon të jetë SHA U Tropojë me normë arkëtimi vetëm 28.7%. Kjo shoqëri gjatë tre viteve 2011 - 2013 jo vetëm ka patur normë të ulët të arkëtimit respektivisht 36%, 29.7%, 28.7%, por edhe tendenca ka qenë negative.




Figura 10. Norma e arkëtimit për grupin 3 në vitin 2013

Në vitin 2013, tendenca e përgjithshme e këtij treguesi në grupin e tretë ka qenë negative. Për shumicën e shoqërive 19 nga 26, norma e arkëtimit ka qenë më e ulët se një vit më parë. Niveli i arkëtimit është ulur ndjeshëm për SHA UK Gjirokastrë Fshat me (-30.9%), SHA U Has me (-24.3%), SHA U Shkodër Fshat me (-19.9%). Mungesa e një menaxhimi efektiv ka sjellë edhe rezultatet e regjistruara. Nga ana tjetër disa shoqëri kanë bërë përmirësime të mëdha ku norma e arkëtimit është rritur ndjeshëm krahasuar me një vit më parë. Listën e kryeson SHA UK Rubik me përmirësimin më të mirë të rritjes së normës së arkëtimit prej 39.4%, e ndjekur nga SHA UK Bashkia Pukë me 18.7%. SHA UK Fushë Krujë me 18.5% e Malësi e Madhe me 14.6%.

Përfundime

Norma mesatare e arkëtimit për sektorin në fund të vitit 2013 shënoi një rënie të fortë kundrejt nivelit të arkëtimit në fund të vitit 2012 (rënie nga 91% në 82%). Në vitin 2013 pak shoqëri kanë vazhduar të bëjnë përpjekje të qëndrueshme për të rritur arkëtimin e të ardhurave, të cilat pavarësisht arsyeve objektive dhe subjektive kanë mundur të rrisin nivelin e arkëtimit duke përmirësuar performancën e shoqërisë.

Përkeqësimi i këtij treguesi për shumicën e shoqërive është rezultat i disa faktorëve: (i) viti 2013 vit elektorale, (ii) vendosja në faturën e furnizimit me ujë e taksave lokale, (iii) rritja vit pas viti e tarifave për disa prej shoqërive si dhe (iv) menaxhim i dobët nga ana e shoqërisë.

ERRU thekson se burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK janë të ardhurat nga aktiviteti, prandaj pavarësisht arsyeve objektive dhe subjektive menaxherët e shoqërive duhet të punojnë për mirë administrimin e të ardhurave. Shoqëritë UK duhet ti kushtojnë më shumë vëmendje faturimit në kohë dhe arkëtimit efektiv në mënyrë që qëndrueshmëria financiare të përmirësohet. Në rast të kundërt borxhi i keq do të rritet. Për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problematik.

Faturimi sistematik i të gjithë klientëve brenda zonës së tyre të juridiksionit, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave duke hapur zyra të kujdesit ndaj klientit lehtësisht të arritshme, ofrimit të mënyrave bashkëkohore të kryerjes së pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu futja në përdorim e arkëtimit të detyruar ndihmojnë në përmirësimin e normës së arkëtimit. Një ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi është ofrimi i shërbimeve cilësore. Eksperiencat tregojnë se shoqëritë që ofrojnë shërbime cilësore kanë edhe normë arkëtimi të lartë. Konsumatorët nuk hezitojnë të paguajnë edhe nëse tarifat rriten.

3.4 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK. Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi sa më efektiv është përmirësimi i efiçencës operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. Duke qenë se kostoja e personelit për momentin zë një përqindje të madhe të kostove të O&M të shërbimeve ujësjellës kanalizime, ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e treguesve kryesorë të performancës. Treguesi i përdorur për të vlerësuar efiçencën e stafit është numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhjeve. ERRU duke patur parasysh veçoritë e operimit të shoqërive ka vendosur nivele të diferencuara objektivash për të tre grupet. Në vitin 2013 niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje për gjithë sektorin është 9.5 punonjës për 1000 lidhje.

Grupi i parë i shoqërive:

Për grupin e parë, ERRU ka përcaktuar si nivel për performancë të mirë 4 punonjës për 1000 lidhje, dhe atë të performancës së dobët 6 punonjës për 1000 lidhje. Në vitin 2013 brenda kufirit të pranueshëm të performancës (6 p/000/lidhje) janë renditur tetë nga 11 shoqëritë e këtij grupi, por vetëm tre dallohen për performancë të mirë (më pak se 4p/000/lidhje): SHA UK Korçë, SHA UK Sarandë dhe SHA UK Tiranë me përkatësisht 2.4, 3.3 dhe 3.6 punonjës për 1000 lidhje. Shoqëria me performancën më të dobët vazhdon të mbetet SHA U Elbasan Fshat. Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje për këtë shoqëri është 12.8 punonjës, gati 6 herë më e lartë se sa shoqëria më e mirë në këtë grup.




Figura 11. Efienca e stafit për grupin e parë në vitin 2013

Krahasuar me vitin 2012, për të gjitha shoqëritë e këtij grupi ky tregues ka patur ndryshime të vogla si pozitive ashtu edhe negative. Tendenca ka qenë pozitive për SHA UK Sarandë, SHA UK Shkodër dhe SHA UK Berat-Kuçovë. Numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me më pak se një person për 1000 lidhje. Në vitin 2013 i njëjti numër punonjësish i ka shërbyer një numri më të madh klientësh se në vitin 2012.

Ndërmjet shoqërive që kanë përkeqësuar treguesin efienca e stafit është, SHA UK Kavajë ku ky tregues ka regjistruar rritjen më të madhe me 1.1 punonjës për 1000 lidhje. Ky ndryshim është rezultat i rritjes së numrit të punonjësve në vitin 2013.

Grupi i dytë i shoqërive:

Për grupin e dytë niveli i objektivit për performancë të mirë të vendosur nga ERRU është 6 punonjës për 1000 lidhje dhe ai për performancë të dobët është 10 punonjës për 1000 lidhje.

Në vitin 2013, katër shoqëri kanë arritur nivelin e performancës së mirë të ERRU. SHA UK Pogradec, është shoqëria me performancën më të mirë me 4.1 punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë janë edhe SHA UK Lezhë, SHA UK Rrogozhinë dhe SHA UK Krujë me respektivisht 5.4, 5.6, 5.9 punonjës për 1000 lidhje. Treguesi i efiençës së stafit është brenda kufijve të performancës së pranueshme (10 p/000 lidhje) edhe për 6 shoqëri të tjera.

Grafiku tregon se tetë shoqëri kanë performancë të papranueshme (ato janë renditur mbi vijën e kuqe të nivelit të performancës së dobët) ku SHA U Patos rezulton me 24 punonjës për 1000 lidhje.




Figura 12. Efienca e stafit për grupin e dytë në vitin 2013

Krahasuar me vitin 2012, ndryshimet pozitive apo negative edhe në këtë grup nuk janë të ndjeshme. Përjashtim bëjnë SHA UK Tepelenë ku efienca e stafit është përmirësuar, (numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me 4.6 punonjës), dhe SHA UK Kurbin e cila ka përqësuar këtë tregues duke rritur numrin e punonjësve për 1000 lidhje me 4.7 persona.

Përmirësimi për SHA UK Tepelenë ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve. Kjo shoqëri që nga viti 2013 ofron edhe shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura. Menaxhimi dhe organizimi me i mirë i punës ka bërë që shoqëria të përballojë rritjen prej 1770 lidhjesh të shërbimit me kanalizime duke shtuar vetëm me 4 punonjës numrin e stafit. Krahasuar me vitin 2012 SHA UK Kurbin në vitin 2013 ka rritur në mënyrë të pajustificuar numrin e punonjësve me 35 persona. Kjo rritje ka përqësuar treguesin efienca e stafit, i cili për këtë shoqëri edhe në dy vitet paraardhëse ka qenë në nivelin e performancës së dobët.

Grupi i tretë i shoqërive:

Për grupin e tretë niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë mirë dhe ai për performancë të dobët janë përkatësisht 10 dhe 15 punonjës për 1000 lidhje.

Në grupin e tretë, 10 nga 26 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është SHA UK Libohovë me 5.2 punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë renditen edhe , SHA UK Ersekë, SHA UK Selenicë, SHA UK Fushë Arrëz, SHA U Vau i Dejës, SHA UK Bilisht, SHA UK Bashkia Pukë, SHA UK Fushë Krujë, SHA UK Delvinë, dhe SHA UK Orikum.

Grupi i shoqërive me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, përbëhet nga 11 shoqëri. E fundit në këtë listë është SHA U Gjirokastër Fshat me 75.9 punonjës për 1000 lidhje, nivel i papranuar punonjësish pavarësisht shtrirjes së gjerë territoriale që ka kjo shoqëri. Nuk është rastësore që edhe mbulimi i kostove nga kjo shoqëri është në nivel tejmase të ulët. Duke u krahasuar me vitin 2012 rezulton se shoqëria ka pothuajse dyfishua numrin e punonjësve të saj (nga 43 në 76 punonjës për 1000 lidhje) . Përqësimi i situatës është rezultat i keqmenaxhimit dhe organizimit të shoqërisë

nga drejtuesit e saj. Gjithashtu edhe SHA U Shkodër Fshat dhe SHA UK Pukë Fshat përkatësisht me 34.4 dhe 31.6 punonjës për 1000 lidhje dallohen për performancë të dobët. Numri i punonjësve në këto shoqëri është 7-8 herë më i lartë sesa ai i shoqërisë më të mirë në këtë grup.




Figura 13. Efienca e stafit për grupin 3 në vitin 2013

Në këtë grup, pjesa më e madhe e kanë përmirësuar këtë tregues edhe pse ato janë të vogla. Këto përmirësime gjykohen të rëndësishme duke pasur parasysh peshën e kostos së personelit në totalin e kostove. Në vitin 2013, shoqëria që dallohet për përmirësim të këtij treguesi është SHA U Has e cila krahasuar me vitin 2012 e ka reduktuar numrin e punonjësve për 1000 lidhje me 7.1 persona. Faktori kryesor është rritja e numrit të klientëve pasi numri i punonjësve është ulur vetëm me një person. Në vitin 2013 shoqëria ka zgjeruar zonën e shërbimit të furnizimit me ujë, duke rritur numrin e klientëve krahasuar me një vit më parë me 26%.

Përfundime

Përmirësimi i efiençës operacionale është i domosdoshëm për arritjen e standardeve më të mira të shërbimit ku përmirësimi i efiençës së stafit është një element i rëndësishëm. i përmirësimit të efiençës operacionale. ERRU e ka përzgjedhur këtë tregues si një ndër treguesit kryesore të vlerësimit të performancës edhe për arsye të ndikimit që ai ka në kostot e shërbimit dhe për rrjedhojë edhe në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive.

Analiza e këtij treguesi për 56 shoqëritë tregoi se niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë sipas grupeve, është arritur vetëm nga 16 shoqëri. Pjesa më e madhe e shoqërive duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të përmirësuar efiençën e stafit. Nivelet e larta të

numrit të punonjësve dhe rritjet e pajustificuara të vëna re për disa shoqëri çojnë në mbipunësim dhe ulje të produktivitetit të punonjësve. Vihet re se si sektor shtimi i numrit të lidhjeve nuk justifikon rritjen e numrit të punonjësve gjatë vitit 2013, fenomen ky që përseritet në vitet elektorale.

Shoqëritë e mëdha arrijnë më lehtë nivele të larta të efikasitetit të stafit se sa shoqëritë më të vogla. Gjithsesi analiza e mësipërme tregon se edhe sistemet më të vogla mund të performojnë si duhet kur kanë një menaxhim të mirë.

ERRU për të nxitur shoqëritë në përdorimin me efektivitet të stafit të tyre, e ka vendosur këtë tregues si një nga treguesit kryesorë të vlerësimit të performancës së shoqërive UK në procesin e ndryshimit të tarifave. Arritja e objektivave të performancës në lidhje me efikasitetin e stafit qëndron në optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të përkushtuar, organizimin e brendshëm të punës, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi si dhe në zgjerimin e bazës së klientëve.

3.5 Uji pa të ardhura

Uji pa të ardhura përfaqëson atë pjesë të ujit të prodhuar e cila i nuk i faturohet konsumatorë, për rrjedhojë nuk gjeneron as të ardhura. Humbjet e ujit ose "Uji pa të ardhura" përbëhet nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive, nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje (në prodhim dhe tek konsumatorët) dhe nga humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës etj).

Në Shqipëri, sasia e ujit të prodhuar nga 58 shoqëri gjatë vitit 2013 është 272.951 mijë m³, ndërsa sasia e ujit që nuk gjeneron të ardhura është 182 573 mijë m³, e shprehur në përqindje mesatarja e ujit pa të ardhura në sektor për këtë vit është 67.4% (e thënë ndryshe pothuajse gjysma e ujit të prodhuar humbet). Niveli i këtij treguesi ka pësuar rritje në krahasim me vitin 2012 duke u larguar kështu akoma më shumë nga objektivi strategjik.

Situata në përkeqësim e këtij treguesi në gjithë sektorin, sidomos në tre vitet e fundit ka qënë një nga shqetësimet kryesorë të ERRU. Rregullatori është i ndëgjegjshëm se reduktimi dhe kontrolli i ujit pa të ardhura është proces kompleks. ERRU vazhdimisht i ka sygjerruar shoqërive UK hartimin e Bilanceve të Ujit si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura. Nisur nga niveli i lartë i humbjeve dhe tendenca negative e këtij treguesi ERRU ndërmoi studimin e humbjeve në sektor bazuar në Bilancin e Ujit. Në vitin 2013 rregullatori përgatiti Modelin e Bilancit të Ujit dhe kërkoi plotësimin e tij nga të gjitha shoqëritë. Me rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi më në detaje do njiheni në temën e veçantë të këtij raporti.

Grupi i parë i shoqërive

Në këtë grup, operatori me performancën më të mirë është SHA UK Korçë e cila krahasuar me vitin 2012 ka një ulje prej 5.21 % të këtij treguesi. Drejt nivelit të objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është afruar dhe SHA U Elbasan Fshat dhe SHA UK Kavajë.

Sikurse edhe gjatë vitit të kaluar, 8 nga 11 shoqëritë, vazhdojnë të qëndrojnë mbi nivelin e objektivit të performancës së dobët prej 50%. SHA UK Tiranë, SHA UK Vlorë, SHA UK Durrës dhe Elber shpk

kanë një përkeqësim të këtij treguesi ndërsa operatorët SHA UK Fier, SHA UK Shkodër, SHA UK Berat-Kuçovë dhe SHA UK Sarandë kanë tendencë drejt përmirësimit të këtij treguesi.




Figura 14. Uji pa të ardhura për grupin 1 në vitin 2013

Po të analizojmë këtë tregues për tre vitet e fundit do të vëmë re se niveli i tij është rritur për SHA UK Tiranë me 13.17%, SHA UK Shkodër me 11.71%, SHA UK Durrës me 4,86 %. Nga analiza rezulton se rritja e sasisë së ujit të prodhuar nuk është shoqëruar me rritje të sasisë së ujit të faturuar. Ky fenomen shoqëron edhe tre operatorët e mësipërm ku përveç rritjes së prodhimit kemi patur dhe ulje të nivelit të faturimit, për pasojë dhe sasia e ujit pa të ardhura është rritur.

Grupi i dytë i shoqërive

Shumica e shoqërive në këtë kategori (11 nga 18 gjithsej) kanë përkeqësim të ujit pa të ardhura gjatë vitit 2013 krahasuar me një vit më parë. Vetëm tre prej tyre kanë nivel të mirë performance, SHA UK Kukës me 17.48%, SHA UK Librazhd me 23,14% dhe SHA U Lushnjë Fshat me 29.33%. Me nivelin mbi 50% të ujit pa të ardhura janë SHA U Peshkopi (55.6%), SHA U Tepelenë (52.16), SHA UK Gjirokastrë (75.29%), SHA UK Lushnjë Qytet (75.28%), SHA U Kurbin (70.24%), SHA UK Krujë (63.84%), SHA UK Burrel (62.17%) dhe SHA U Mallakastër (56.13%).




Figura 15. Uji pa të ardhura për grupin 2 në vitin 2013

Vlen të theksohet se edhe shoqëri me një performancë të përgjithshme të mirë sikurse është SHA UK Pogradec humbjet e ujit janë rritur me 15.1%. përkeqësim më i madh i këtij treguesi vihet re edhe në shoqëritë si: SHA UK Rrogozhinë me 19.82%, SHA UK Patos me 12.01% dhe SHA U Korçë Fshat me 5.6%. Gjatë krahasimit të të dhënave për dy vitet e fundit rezulton se shoqëritë Pogradec, Patos dhe Rrogozhinë kanë rritur sasinë e ujit të prodhuar por kjo nuk është shoqëruar me rritje të nivelit të faturimit. Për SHA UK Pogradec në rritjen e humbjeve ka influencuar rritja e sasisë së ujit të humbur në rrjetin shpërndarës (sipas Revistës Burimi Ujit 2013) si dhe mungesa e matësave për klientët në zonat informale. Për SHA UK Rrogozhinë dhe SHA UK Patos mungesa e matësave në prodhim dhe tek konsumatorët bën që ky tregues të ketë luhatje jo të pranueshme. Shoqëritë me rezultatet më të mira në reduktimin e ujit pa të ardhura janë SHA UK Burrel me (-12.24%) si dhe SHA UK Mallakastër me (-18.8%).

Grupi i tretë i shoqërive

Në këtë grup 17 nga 27 shoqëri vazhdojnë të kenë një nivel të lartë humbesh mbi 50%. SHA U Këlcyre ka bërë përpjekje duke ulur me 2.27 % humbjet por vazhdon të jetë operatori me nivelin më të lartë të humbjeve (83.13%) i ndjekur nga SHA UK Fushë Arrëz (79.51%), SHA U Tropojë me (75.71%), SHA U Malësia e Madhe (74.62%) etj.




Figura 16. Uji pa të ardhura për grupin 3 në vitin 2013

Shoqëritë që për vitin 2013 kanë rritur nivelin e ujit pa të ardhura janë SHA U Delvinë me 7.96%, SHA U Orikum me 7.61%, SHA U Shkodër Fshat me 8.29%, SHA U Malësi e Madhe me 13.44%, SHA U Tropojë me 6.14% dhe SHA U Fushë Arrëz me 5.15%. Rritja e nivelit të humbjeve për këto shoqëri ka ardhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë. Pa ndonjë shkak të arsyeshëm sasia e ujit të prodhuar për vitin 2013 është rritur dhe sasia e ujit të faturuar ka pësuar ulje.

Në grupin e tretë, operatorët me performancë të mirë për këtë tregues janë SHA UK Rubik (13.61%), SHA U Gjirokastrë Fshat (19.67%), SHA U Divjakë (22.25%), SHA UK Peqin (23.53%), SHA U Bulqizë (29.49%) dhe SHA UK Libohovë (29.84%). Për tu përgëzuar janë operatorët SHA UK Peqin, SHA U Bulqizë dhe SHA UK Libohovë të cilët për këtë vit kanë arritur kufirin e performancës së mirë. Gjithashtu dhe SHA U Has ka përmirësim të këtij treguesi në vlerë 25,55 % por mbetet akoma punë për tu afruar në kufirin e mirë të performancës.

Përfundime

Viti 2013 shënon një përkeqësim të mëtejshëm të ujit pa të ardhura, si rrjedhojë e humbjeve në prodhim, shpërndarje dhe faturim. Niveli prej 67.4% është alarmant për menaxherët e shoqërive UK. Nga analiza e bërë rezulton se gjendja në sektor është shumë shqetësuese, vetëm për 10 shoqëri niveli i ujit pa të ardhura është në nivelin e performancës së mirë, ndërsa për 33 operatorë uji që nuk gjeneron të ardhura është më shumë se 50% e sasisë së ujit të faturuar. Kjo jep sinjalin se shoqëritë kanë për detyrë të marrin masa urgjente duke filluar me rikonstruksionin e sistemeve të ujësjellësit, evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, rritjen e efikasitetit të energjisë si një komponent që rëndon shumë koston e prodhimit, rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimit, vendosjen e matësve në prodhim, matësve të bilancit dhe ato në shpërndarje për të njohur situatën reale të humbjeve.

Një faktor tjetër që rëndon më tepër situatën është dhe pasaktësia e të dhënave të raportuara, e cila

nuk na mundëson një situatë reale dhe për pasojë gjykim real të problemit. Pasqyrimi me saktësi dhe vërtetësi i realitetit ndihmon së pari shoqëritë në vetëvlerësimin e situatës por edhe palët e interesit për këtë sektor. Për herë të parë gjatë vitit 2013 ERRU realizoi përgatitjen dhe analizën e bilanceve të ujit të shoqërive UK. Analiza e bilanceve të ujit tregoi se në total humbjet menaxheriale (nga mos arkëtimi i të ardhurave) janë më të mëdha se ato teknike, pra përveçse një sistemi të am-ortizuar niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shoqërive.

Krahasuar me vitin 2011 niveli i ujit pa të ardhura është rritur me rreth 4%. Reduktimin e ujit pa të ardhura, ERRU e ka parë gjithmonë si një nga treguesit kryesor për të patur shoqëri të qëndrueshme financiarisht. Për këtë arsye rregullatori nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese afat-gjatë mbështet shoqëritë në punën e tyre që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt për këtë sektor.

4.6 Niveli i matjes

Niveli i matjes është raporti i lidhjeve me matës kundrejt numrit total të lidhjeve. Aktualisht ky treg-ues nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë, pasi analizon vetëm lidhjet me matësa tek konsumatori. ERRU është i mendimit që në të ardhmen këtij treguesi ti shtohen indi-katorë të tjerë në mënyrë që të kemi një analizë më të plotë të nivelit të përgjithshëm të matjes në sistemet e furnizimit me ujë: prodhim, depo e shpërndarje. Kjo do të sjellë një rezultat më të saktë dhe të verifikueshëm të Bilancit të Ujit si dhe do të ndihmojë për të evidentuar nevojat e shoqërisë për të përmirësuar këtë tregues. Rritja e nivelit të matur rrit saktësinë edhe të treguesit “uji pa të ardhura”.

Për vitin 2013 ky tregues vlerësohet pozitivisht, pasi tendenca e tij ka qenë pozitive. Niveli i shër-bimit të matur ka ardhur duke u rritur vit pas viti, nga 50.6% në vitin 2011, në 55.1% për vitin 2012, dhe 59% në vitin 2013. Sektori është shumë afër objektivit prej 60% për këtë tregues përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, por larg objektivit 85% të vendosur nga ERRU për operatorët UK. Rregullatori e vlerëson nivelin e matjes shumë të rëndë-sishëm pasi ai ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët por edhe në cilësinë e disa treguesve të tjerë.

Grupi i parë i shoqërive:

Edhe për këtë vit shoqëria me performancë më të mirë për grupin e parë, vazhdon të jetë SHA UK Korçë e cila e mat tërësisht (100%) shërbimin e ofruar. Në këtë grup vërehet rritje e këtij treguesi për të gjitha shoqëritë me përjashtim të dy prej tyre: SHA.UK Sarandë dhe SHA UK Berat-Kuçovë. Krahasuar me vitin 2012 për SHA.UK Sarandë niveli i matur është ulur me 4.68 %. Në vitin 2013 numri i klientëve është rritur pasi shoqëria ofron shërbimin e furnizimit me ujë edhe për 14 fshatra të cilat më parë mbuloheshin me shërbim nga Komunat. Këta klientë i përkasin shërbimit të pamatur. Edhe për SHA UK Berat-Kuçovë niveli i matur është ulur me 4.67% krahasuar me një vit më parë. Ndonëse numri total i klientëve është rritur, niveli i matjes për arsye të dëmtimit të matësave dhe mos zëvendësimit të tyre në kohë është ulur.

Shoqëria me shkallën më të ulët të shërbimit të matur, mbetet SHA UK Shkodër me 16.19 %, por duhet theksuar se kjo shoqëri ka pasur një rritje prej 8.18 % të këtij treguesi krahasuar me vitin 2012.




Figura 17. Niveli i matjes për grupin 1 në vitin 2013

Ecuria më pozitive është shënuar sërish për SHA UK Fier, e cila në vitin 2013 e ka rritur këtë tregues me 16.08%, krahasuar me vitin 2012, ndërsa krahasuar me vitin 2011 niveli i matur është rritu me 44.01%. Shoqëria është në fazën përfundimtare të instalimit të matësve të dixhitalizuar. Puna ka ecur me ritme të kënaqshme dhe brenda pak kohësh shoqëria do të ofrojë shërbim 100% të matur. Gjithashtu rritje të këtij treguesi ka pasur dhe shoqëria SHA UK Durrës me 6.25 %, krahasuar me vitin 2012.

Grupi i dytë i shoqërive:

Për vitin 2013 në këtë grup vazhdojnë të qëndrojnë 3 shoqëri që kanë tejkaluar kufirin e performancës së mirë prej 85%: SHA U Lushnjë Fshat (100%), SHA UK Librazhd (95.87%) dhe SHA UK Pogradec (91.91%). Ndërsa SHA UK Krujë është shumë pranë kalimit të këtij kufiri. Përgjithësisht gjatë vitit 2013 vihet re se shoqëritë kanë rritur nivelin e matjes, ose kanë ruajtur të njëjtin nivel kundrejt vitit 2012 me përjashtim të tre operatorëve: Tepelenë, Peshkopi dhe Librazhd.

Grafiku tregon se shoqëria me performancën më të mirë në këtë grup është SHA U Lushnjë Fshat, me 100% shërbim të matur. Në të vërtetë ky tregues reflekton matjen e ofrimit të ujit të pijshëm nga shoqëria komunave ku ofrohet shërbimi dhe jo matja e konsumit nga familjarët, bizneset apo institucionet publike. Ndoshta kjo është arsyeja që performanca e kësaj shoqërie për këtë tregues është në këtë nivel. . SHA U Kurbin, SHA UK Gjirokastrë dhe SHA U Patos vazhdojnë të kenë performancë shumë të dobët lidhur me shërbimin e matur, i cili zë më pak se 1%.




Figura 18. Niveli i matjes për grupin 2 në vitin 2013

Progres në lidhje me këtë tregues ka bërë SHA UK Burrel duke e rritur nivelin e matjes me (+14.78%) krahasuar me vitin 2012. Ndërsa rënie të këtij treguesi kanë raportuar 5 shoqëri, por 2 nga këto kanë rënie të dukshme përkatësisht SHA UK Tepelenë (-7.99%) dhe SHA UK Peshkopi (-5.77%). Bazuar në raportimet e bëra nga SHA UK Tepelenë, rezulton se krahasuar me 2012, nuk ka pasur ndryshim në zonën e shërbimit të shoqërisë, pra edhe të numrit të klientëve, por niveli i matjes është ulur për arsye të mos zëvendësimit të matësave të dëmtuar. Ndërsa SHA UK Peshkopi ka raportuar rritje të numrit total të lidhjeve, si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit, por nga ana tjetër ka rënie të nivelit të matjes pasi këta klientë i përkasin shërbimit të pamatur. Shoqëria është në pritje të zbatimit të projektit të qeverisë austriake, i cili do të fillojë në fund të vitit 2014, dhe parashikon rehabilitimin e të gjithë rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë për qytetin e Peshkopisë dhe vendosjen e matësve për të gjithë konsumatorët.

Grupi i tretë i shoqërive:

Shërbimi i matur për shoqëritë e këtij grupi edhe për gjatë vitit 2013 ka shënuar nivele të ulëta. Përveç SHA U Divjakë vazhdon të raportojë 100% shërbimin e matur të gjitha shoqëritë e tjera janë nën nivelin e performancës së mirë ku 23 prej tyre kanë më pak se 50% të lidhjeve me matës. Këtu bëjnë pjesë edhe 6 shoqëri të cilët nuk e masin fare shërbimin e ofruar.

Megjithatë krahasuar me vitin 2012, shtatë shoqëri të këtij grupi kanë bërë progres në nivelin e matjes. Dallojnë për rritje të nivelit të matur SHA U Has me (36.08%) dhe SHA U Shkodër Fshat me (20.59%). Gjithashtu rritje të këtij treguesi kanë shënuar edhe SHA UK Peqin me (10.91%), SHA U Ura Vajgurore me (10.31%), SHA UK Ersekë me (9.27%), SHA UK Rubik me (6.48%) dhe SHA U Bulqizë me (6.22%).




Figura 19. Niveli i matjes për grupin 3 në vitin 2013

Në këtë grup, në vitin 2013 niveli i matjes ka patur tendencë negative për 9 shoqëri. Rënien më të madhe e ka shënuar SHA UK Mirditë (-5.68%). Nga analiza rezulton se krahasuar me vitin 2012 numri total i lidhjeve nuk ka ndryshuar. Numri i lidhjeve pa matës është rritur aq sa është ulur numri i lidhjeve me matës, që tregon se shoqëria nuk ka marrë masa për të zëvendësuar matësat e dëmtuar. Ndërsa shoqëritë e tjera kanë shënuar ulje shumë të vogla të nivelit të matur nga -0.02% në -0.47%.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet, rezulton se shërbimi i matur është rritur, por shoqëritë kanë shumë punë për të bërë për të arritur objektivat e vendosura në strategjinë kombëtare (60%) dhe atë të Entit Rregullator (85%). Një pjesë e shoqërive operojnë mbi nivelin e performancës së mirë të këtij treguesi. Në grupin e dytë dhe të tretë evidentohen shoqëri, kryesisht ato të vogla, që pothuajse nuk ofrojnë shërbim të matur për konsumatorët.

Shoqëritë e grupin I dhe e grupit II kanë një nivel mesatar të matjes është mbi 50% ndërsa për grupin III niveli mesatar të matjes nuk arrin më shumë se 25 %, pothuajse sa gjysma e dy grupeve të para. Megjithatë niveli i matur ka patur ecure pozitive për pjesën më të madhe të shoqërive të këtij grupi.

Zëvendësimi i faturimit me tarifa të sheshta/afrofe bazuar në konsumin e vlerësuar me faturimin real volumetrik do të ulte nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive. Operatorët kanë patur detyrim (bazuar në dy vendimet e Këshillit të Ministrave) që deri në fund të vitit 2010 të kishin përfunduar instalimet e matësve për të gjithë klientët jo familjarë dhe objektivi për të ardhmen është që të pajisen me matës dhe klientë familjarë. Por kjo nuk është realizuar pasi në nivel sektori ende 14 606 klientë jo familjarë nga 60 179 që janë gjithsej nuk janë të pajisur me matës. Në krahasim me vitin 2012 numri total i klientëve jo familjarë është rritur me 2 827 klientë dhe këto janë të pajisur me matës.

Shoqëritë SHA U Divjakë, SHA UK Fushë Krujë, SHA UK Kavajë, SHA UK Korçë, SHA U Korçë Fshat, SHA UK Librazhd, SHA U Lushnjë Fshat, SHA U Përmet, SHA UK Pogradec, SHA UK Pukë, SHA UK Rubik dhe SHA U Vau i Dejës kanë përfunduar instalimin e matësve për të gjitha lidhjet privat/biznese.

Në mënyrë të vazhdueshme dhe gjatë vitit 2013 ERRU ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve nëpërmjet informacioneve por edhe inspektime tek shoqëritë. Duke qënë ky një detyrim ligjor, ERRU ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë instalimin e matësve për të gjitha lidhjet e reja, për të reduktuar nivelet e larta të shërbimit të pa matur

4.7 Kohëzgjatja e furnizimit me ujë

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e tij mbeten dy nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit, ku dhe konsumatorët janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të këtij treguesi. Kur këta dy tregues të arrijnë në nivelin e standardeve të kërkuara, konsumatorët nuk do të kërkojnë burime të tjera furnizimi. Çdo përmirësim në secilin prej tyre do të vihet re dhe mirëpritet nga konsumatorët. Për vlerësimin e këtij treguesi është përdorur mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, tregues i cili për vitin 2013 është 11.5 orë/ditë, me një rritje të ndjeshme nga viti 2012, ku mesatarja ishte 10.8 orë/ditë, por akoma larg objektivit të performancës së mirë nga ERRU i cili është 18 orë në ditë.

Grupi i parë i shoqërive:

Në këtë grup për vitin 2013 ofrohet mesatarisht 13.66 orë/ditë furnizim me ujë. Krahasuar kjo vlerë e këtij treguesi me vitin 2012 që ka qënë 14.2 orë/ditë, vihet re se ka rënë kohëzgjatja e e furnizimi me ujë të pijshëm me 0.54 orë/ditë. Në përgjithësi (siç vihet re dhe nga grafiku) shoqëritë e këtij grupi kane pasur rritje ose nivel të njëjtë të orëve të furnizimit në krahasim me vitin 2012, por kjo rënie ka ardhur nga përfshirja në grupin e parë të SHA UK Sarandë, për shkak të zgjerimit të zonës së saj të shërbimit. Në këtë grup vetëm tre shoqëri gjenden mbi kufirin e performancës së mirë: SHA UK Korçë vazhdon të mbetet e vetmja shoqëri që ofron 24 orë/ditë furnizim me ujë, e pasuar nga SHA UK Shkodër e SHA UK Fier të cilat ofrojnë përkatësisht 21.57 dhe 20.21 orë në ditë duke pasur gjithashtu edhe përmirësim kundrejt vitit 2012.

Dy nga shoqëritë që ofrojnë furnizim me ujë nën kufirin e performancës së dobët në këtë grup, me më pak se 8.0 orë/ditë janë SHA UK Durrës që furnizon me 7.55 orë/ditë dhe SHA UK Sarandë me 4.79 orë/ditë.




Figura 20. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 1 në vitin 2013

Vlen të theksohet që UK Durrës ka pasur rritje me 1.34 orë/ditë furnizim me ujë nga viti 2012 dhe me 2.43 orë/ditë krahasuar me vitin 2011, por përsëri ka mbetur nën nivelin e kufirit të performancës së dobët. Niveli i këtij treguesi për SH.A UK Sarandë, krahasuar me vitin 2012 ka pasur një rritje shumë të vogël me 0.23 orë/ditë furnizim me ujë. Megjithatë kjo shoqëri mbetet nën kufirin e performance se dobët të këtij grupi.

Për shoqëritë e tjera të këtij grupi është për t'u vlerësuar ecuria e këtij treguesi nga viti në vit pasi vihen re ndryshime pozitive. Gjatë viti 2013, 7 nga 10 shoqëri të grupit të parë kanë bërë përmirësim në rritjen e orëve të furnizimit me shërbim. Krahasuar me vitin 2011 SHA UK Elbasan Fshat ka regjistruar përmirësimin më të madh me 2.6 orë në ditë. UK Kavajë nuk ka ndryshim duke qëndruar në 9.2 orë furnizim me ujë në ditë nga viti 2012 në vitin 2013.

Grupi i dytë i shoqërive:

Shoqëritë e grupit të dytë për vitin 2013 ofrojnë mesatarisht 11.85 orë ujë në ditë ndërsa për vitin 2012 ka qenë 11.3 orë ujë në ditë duke e rritur me 0.55 orë ujë në ditë krahasuar me një vit më parë. Në këtë grup 4 nga 18 shoqëri kanë arritur nivelin e performancës së mirë për sa i përket furnizimit të vazhdueshëm: SHA UK Librazhd, SHA UK Pogradec, SHA UK Lezhë dhe SHA U Gramsh. SHA UK Librazhd është performuesi më i mirë në këtë grup me 24 orë në ditë shërbim të ofruar. Në këtë grup rritjen më të madhe të këtij treguesi për vitin 2013 e ka UK Peshkopi me 4.09 orë në ditë më shumë dhe U Përmet me 3.31 orë në ditë më shumë.

Në këtë grup 6 shoqëri kanë nivelin e këtij treguesi nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë) SHA Lushnjë Fshat, SHA UK Krujë, SHA UK Lushnjë, SHA U Kurbin, SHA U Patos, dhe SHA UK Gjirokastrë. Performuesi më i keq në këtë grup është SHA U Patos, ku konsumatorët furnizohen me vetëm 2.8 orë ujë në ditë.




Figura 21. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 2 në vitin 2013

Për katër nga shoqëritë e këtij grupi ka pasur ulje të orëve të furnizimit me ujë. UK Tepelenë ka pasur 3.36 orë në ditë më pak dhe UK Mallakastër 1.51 orë në ditë më pak krahasuar kjo me vitin 2012, por që përsëri mbeten në nivelin me performancë të mirë. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e punimeve të shumta për riparime gjatë këtij viti që kanë bërë këto dy shoqëri.

Shoqëritë UK Krujë dhe U Kurbin kanë pësuar ulje nga viti 2012 përkatësisht me 2.1 dhe 1.23 orë në ditë më pak duke ulur më shumë performancën e dobët. UK Gjirokastrë ka pësuar një rritje me 0.83 orë në ditë më shumë për vitin 2013 por përsëri mbetet në nivelin e dobët.

Grupi i tretë i shoqërive:

Shoqëritë e grupit të tretë ofrojnë mesatarisht 9.44 orë ujë në ditë për vitin 2013 duke pësuar një rritje të vogël me furnizim 0.14 orë ujë në ditë krahasuar me 2012. Edhe për këtë vit SHA UK Rubik vazhdon të jetë performuesi më i mirë i këtij grupi me 23.8 orë në ditë sikurse më të mirët e grupeve 1 dhe 2 dhe që kanë pasur një rritje prej 1.17 orë në ditë më shumë se viti 2012.

Është për t'u vlerësuar rritja që shihet në këtë grup për 15 shoqëri krahasuar me 2012. Nga këto shihet një rritje drastike për shoqëritë UK Ersekë me 6.95 orë/ditë më shumë, UK Bashkia Pukë me 6.66 orë/ditë më shumë dhe UK Fushë Arrëz me 6.83 orë/ditë më shumë furnizim me ujë.




Figura 22. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 3 në vitin 2013

Në kufijtë e performancës së mirë janë operatorët UK Rubik dhe UK Ersekë. Në kufijtë e performancës së pranueshme janë 12 shoqëri me orare furnizimi prej 8 dhe 18 orë në ditë. Shoqëria me performancën më të dobët përse i përket orëve të furnizimit me ujë është U Divjakë me vetëm 3.98 orë në ditë. Shoqëritë Novoselë dhe Bradashesh nuk kanë raportuar të dhëna.

Shoqëritë që kanë regjistruar ulje të këtij treguesi krahasuar me 2012 janë UK Fushë Krujë (-0.56 orë/ditë), UK Pukë Fshat (-0.42 orë/ditë), UK Mirditë (-0.25 orë/ditë), U Gjirokastër fshat e cila ka dhe uljen më të madhe në këtë grup me (-2.89 orë/ditë), U Delvinë (-1.01 orë/ditë), UK Libohovë (-1.54 orë/ditë), U Bulqizë (-1.19 orë/ditë), U Këlcyrë (-0.45 orë/ditë), U Peqin (-0.02 orë/ditë), U Orikum (-0.20 orë/ditë), U Ura Vajguore (-1.16 orë/ditë) dhe U Divjakë (-0.41 orë/ditë),

Përfundime

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për vitin 2013 ka qënë mesatarisht me 11.5 orë ujë në ditë duke pësuar rritje nga 10.8 orë ujë në ditë që ka qënë për vitin 2012. Me gjithë rritjen, përsëri ky tregues vazhdon të jetë nën nivelin e objektivit strategjik për vitin 2013, i cili është 14 orë në ditë, si dhe nën nivelin e objektivit prej 18 orë në ditë të vendosur nga ERRU për performancë të mirë. Konsumatorët vazhdojnë ta zgjidhin me burime alternative problemin e furnizimit me ujë. Nga analiza e të tre grupeve vihet re se klientët e disa shoqërive janë përballur me ulje në orët e furnizimit gjatë vitit 2013, problem ky që rrjedhimisht i çon konsumatorët, kryesisht ata të mëdhenj (privatë), drejt gjetjes së formave të tjera të furnizimit. Si pasojë shoqëria humbet klientët potencial dhe ul të ardhurat. Për të tre grupet eksperiencia e shoqërive me performancë të mirë tregon se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet por mund të arrihet edhe nëse shoqëria menaxhohet më mirë.

ERRU inkurajon shoqëritë në përpjekjet e tyre për të rritur qëndrueshmërinë për sa i përket ofrimit të këtij shërbimi. Një nga prioritetet e ERRU vazhdon të mbetet përmirësimi i shërbimit për konsumatorët. Të dy treguesit e vendosur për vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, që janë të lidhur dhe me ndryshimin e tarifave, aktualisht janë kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e ujit të pijshëm.

ERRU ka vendosur objektiva mbi performancën e operatorëve për këta tregues dhe më pas monitoron ecurinë për objektivat e vendosur. ERRU do t'ju kërkojë operatorëve të përfshijnë këto objektiva në planet e tyre të biznesit për të gjetur rrugët dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

3.8 Cilësia e ujit të pijshëm

Një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së një shoqërie është padyshim cilësia e ujit të pijshëm, e cila ka një rëndësi të veçantë duke qenë se është e lidhur drejtpërdrejt me shëndetin e konsumatorit. Treguesi i cilësisë së ujit të pijshëm merr në analizë: (i) testet e koliformit dhe (ii) klorit mbetës, dy të dhëna që masin standartin e ujit cilësisht të pijshëm. ERRU merr të dhëna në lidhje me këta tregues të ujit të pijshëm nga raportimet e shoqërive dhe ISHP.

ISHP nëpërmjet Drejtorive Rajonale në 51 bashki dhe komuna në të gjithë vendin është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në këtë sektor. Këta të fundit, marrin kampione në pika të ndryshme të zonës së shërbimit të operatorit dhe bëjnë testimin e parametrave të përcaktuara prej tyre. ISHP është institucioni kryesor përgjegjës për mbledhjen e të dhënave nga këto drejtori. Në rastin kur cilësia e ujit të pijshëm nuk rezulton në nivele të pranueshme, DSHP monitoron shoqërinë deri në zgjidhjen e situatës dhe merr masat që konsumatorët të marrin informacion të menjëhershëm lidhur me situatën.

Në kuadër të analizës së performancës së këtij treguesi, ERRU përqendrohet në dy parametra kryesorë për të vlerësuar sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm: zbatimin e standarteve bakteriologjike (koliformi) dhe të klorit mbetës të cilët bëjnë të mundur të kemi një konsumator të mbrojtur dhe njëkohësisht “ujë cilësisht të pijshëm” sipas standarteve shtetërore të vendosura. Çdo papajtueshmëri me standartet bakteriologjike dhe klorin mbetës, përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve.

Mungesa e baktereve koliforme rikonfirmon sigurinë e përgjithshme mikrobiologjike të ujit të pijshëm për publikun ndërsa nivelet përkatëse të klorit mbetës tregojnë që uji mbetet i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme gjatë depozitimit dhe shpërndarjes. Për të bërë këtë vlerësim, ERRU ka vendosur që nivelet e ulëta e të larta, të performancës së dobët dhe të pranueshme, të jenë përkatësisht 95% dhe 90%.

Analiza e performancës së këtij treguesi në vitet paraardhëse është bazuar mbi të dhënat e raportuara nga shoqëritë në Njësinë e Monitorimit dhe Benchmarking (NJMB). Për vitin 2013 këto të dhëna u verifikuan edhe me të dhëna nga burime të tjera. Informacioni që ERRU merr nga ISHP nëpërmjet “Buletinit të Ujit të pijshëm” tregon se disa prej shoqërive kanë shumë pika të ndotura madje edhe të përsëritura nga muaji në muaj. Rregullator lidhi një marrëveshje të re bashkëpunimi për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe shkëmbimin e informacionit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik, marrëveshje e cila synon të shtrihet edhe në nivelin e Drejtorive të

Shëndetit Publik në Qarqe dhe shoqërive UK. Rregullatori synon të përmirësojë jo vetëm informacionin që do të mbledhë në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm nga operatorët por edhe përmirësimin e marrjes së masave nga këta të fundit për rritjen e cilësisë së ujit të pijshëm.

Nga të dhënat e marra nga NjMB rezulton se për vitin 2013 vetëm 6 shoqëri: Korçë Fshat, Gramsh dhe Divakë, Lushnje, Berat-Kuçovë dhe Durrës kanë tregues të cilësisë së ujit nën nivelin prej 95%, gjë që nuk konfirmohet nga rezultatet e ISHP-së, ku sipas kësaj të fundit vetëm për muajin dhjetor 2013 nga 58 shoqëri vetëm 4 prej tyre janë mbi nivelin 95% për elementin klori mbetës dhe 39 për koliformin total. Diferencë kjo dukshëm shumë e ndryshme nga ajo çfarë është testuar aktualisht nga ISHP. Edhe pse informacioni nga ISHP është më i besueshëm sesa ai i NjMB edhe ky informacion është përsëri i pakët pasi deri më sot ISHP monitoron vetëm 59% të popullsisë për cilësinë e ujit të pijshëm. Gjithashtu infrastruktura laboratorike e DPSH-ve nuk është e tillë që të monitorojë të gjithë elementët që janë pjesë e standardit kombëtar të cilësisë së ujit të pijshëm.

ERRU kujdeset që shoqëritë e licensuara të kenë prioritet zbatimin e procedurave të përshtatshme në mënyrë që konsumatorët të mbahen të informuar lidhur me cilësinë e furnizimit me ujë dhe riskun e ndotjes. Është gjithashtu e nevojshme që procedurat mbi kampionimin dhe testimin e cilësisë së ujit të pijshëm të jenë në përputhje me praktikën më të mira, d.m.th në intervale të rregullta në secilin prej impianteve të trajtimit, rezervuarëve si dhe një përzgjedhje rastësore nga rubinetet e konsumatorëve.

Disa nga faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit dhe ç'rregullime në furnizim janë: (i) furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, (ii) ndryshimet në presionin e ujit, (iii) shpimi i tubave për lidhje të paligjshme, (iv) mbajtja e ujit në depozita, dhe (v) pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët për të kompensuar presionin e ulët të rrjetit.

ERRU do të vazhdojë të tërheqë vëmendjen e këtyre shoqërive mbi të gjithë treguesit kryesorë të performancës të lidhur me cilësinë e ujit për të minimizuar rrezikun ndaj shëndetit publik. ERRU synon që cilësinë e ujit në raportin e performancës për vitin 2014 ta vlerësojnë tërësisht në të dhënat e marra nga ISHP si një e dhënë e besueshme që garanton jo vetëm informim të saktë por edhe vlerësim real të shoqërisë në lidhje me cilësinë e ujit që ata prodhojnë dhe shpërndajnë për konsumatorët. Kjo edhe arsyeja që në këtë raport nuk do të paraqitet klasifikimi i shoqërive në lidhje me këtë tregues.

3.9 Mbulimi me kanalizime

Treguesi i mbulimit me kanalizime është raporti i popullsisë së shërbyer me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një operatori. Deri më tani, ERRU në analizën e performancës së shoqërive, ka vlerësuar vetëm këtë tregues si i vetmi nga treguesit sasiorë që i përket shërbimit të largimit të ujërave të ndotur. Mbetet ende shumë i vogël mbulimi i popullatës me shërbimin e kanalizimeve. niveli prej 51% jo vetëm është i ulët por vazhdon të mbetet pothuajse i pandryshuar për vite me rradhë. ERRU është duke punuar dhe po mendon të përcaktojë dhe tregues e nën tregues të tjerë sasiorë dhe cilësorë, që kanë të bëjnë jo vetëm me këtë shërbim kaq të rëndësishëm, por edhe për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura. Këto tregues do të futen si pjesë e vlerësimit të performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime në raportimet gjatë viteve të ardhshme.

Përsa i përket shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, vetëm 30 shoqëri ujësjellës kanalizime që operojnë në Shqipëri, nga 58 prej tyre, e ofrojnë këtë shërbim. Për pjesën e mbetur të popullsisë

ky shërbim ose ofrohet nga njësitë e qeverisjes vendore ose është individual, sigurohet nga vetë banorët nëpërmjet gropave septike të ndërtuara pa standarde teknike të miratuara.

Lëvizjet demografike të vazhdueshme bëjnë të mundur që treguesi i mbulimit me kanalizime të mos jetë i qëndrueshëm për shumë operatorë. ERRU ka vendosur që kufiri për një performancë të mirë për këtë tregues të jetë 75%. Edhe pse rregullatori ka vendosur një nivel të ulët si objektiv të synuar për performancë të mirë ai është ende shumë larg arritjes nga shoqëritë që operojnë në vend.

Gjatë vitit 2013 dhe 2014 ERRU në bashkëpunim me GIZ ndërmori një studim për vlerësimin e cilësisë dhe standarteve kombëtare për monitorimin e ujërave të zeza. Përfundimi i këtij vlerësimi ishte edhe më alarmant në lidhje me ujërat e zeza sesa uji i pijshëm. Sipas këtij studimi standardet kombëtare për ujërat e zeza ekzistojnë vetëm për ujërat e zeza pas përpunimit dhe pikat e monitoruara në të gjithë vendin janë shumë të pakta. Agjensia Kombëtare e Mjedisit si autoriteti për monitorimin e këtij sektori ka një laborator të vetëm, të paisur me aparatura bashkëkohore, si dhe me një personel të trajnuar, që merret, ndër të tjera, edhe me analizimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura. Por kësaj agjensie i mungojnë kapacitetet e mjaftueshme për të mbuluar me monitorim të gjithë vendin. Agjensite Rajonale të Mjedisit si institucione varësie, nuk kanë laboratore dhe aftësitë e personelit të këtyre institucioneve janë shumë të kufizuara për kontrollin e shkarkimeve të ujërave të ndotura. Evidentohet se aktualisht rrjeti i monitorimit të shkarkimeve urbane përbëhet nga 35 - 40 stacione (pika) monitorimi në nëntë zona/qytete (lumenj dhe / ose zona bregdetare) duke mbuluar një popullsi prej rreth 1.318.155 banorë ose rreth 37% të totalit. Këto pika kontrollohen në frekuencën 4 herë në vit ose me fushata gjatë periudhës së verës.

Të dhënat e monitorimit të shkarkimeve të ujërave të ndotura raportohen nga AKM dhe bëhen publike një herë në vit nëpërmjet raportit "Gjendja e Mjedisit në Shqipëri" që botohet nga Ministria e Mjedisit.

Grupi i parë i shoqërive:

Shoqëritë shpk Elber, SHA UK Korçë dhe SHA UK Tiranë vazhdojnë të ruajnë të njëjtën shkallë mbulimi duke qëndruar kështu dhe performuesit më të mirë për këtë tregues.




Figura 26. Mbulimi me Kanalizime për grupin 1 në vitin 2013

Me keq paraqitet shoqëria SHA UK Kavajë (24.77%) ndërsa SHA UK Durrës (48.4%) ka rënie të këtij treguesi me 4.44% për arsye të shtimit të popullsisë në zonën e juridiksionit si dhe të uljes së numrit të klientëve (kjo për shkak se shoqëria ka bërë verifikimin e numrit të klientëve me futjen në punë të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura).

Shoqëria SHA UK Fier vazhdon të rrisë edhe për këtë vit zonën e mbulimit me 4.17%, krahasuar me tre vitet e fundit. Ky është i vetmi operator që ka rritur mbulimin me 7.48%.

Grupi i dytë i shoqërive

Nga 18 shoqëri të grupit të dytë, 10 shoqëri ofrojnë shërbimin me kanalizime dhe vetëm 4 prej tyre SHA UK Krujë, SHA UK Lezhë, SHA UK Librazhd dhe SHA UK Pogradec qëndrojnë mbi kufirin e performancës së mirë prej 75%.




Figura 27. Mbulimi me Kanalizime për grupin 2 në vitin 2013

Shoqëria SHA UK Tepelenë (54.58%) raporton për herë të parë mbi këtë shërbim. Me performancë më të dobët vazhdojnë të mbeten SHA UK Gjirokastër Qytet (37.75%), SHA UK Mallakastër (27.5%) dhe më keq akoma SHA UK Rrogozhinë (16.18%).

Vlen për t'u theksuar se asnjëra nga shoqëritë nuk po bën përpjekje të dukshme për të rritur shkallën e mbulimit me kanalizime.

Grupi i tretë i shoqërive

Shërbimin me kanalizime në grupin e tretë e kryejnë vetëm 11 shoqëri. SHA UK Ersekë për të tre vitet e fundit vazhdon të ketë treguesin e mbulimit me kanalizime në vlerën 100% duke u renditur e para në këtë grup. Për t'u përgëzuar është SHA UK Delvinë e cila ka rritur zonën e mbulimit me 36.61 % në krahasim me vitin e kaluar.




Figura 28. Mbulimi me Kanalizime për grupin 3 në vitin 2013

Një rritje të ndjeshme të këtij treguesi prej 34.91% ka patur dhe SHA UK Libohovë, por siç shihet dhe në grafik, ka akoma punë për të bërë për t'ju afruar kufirit të performancës së mirë.

Me performancën më të dobët vazhdojnë të jenë SHA UK Pukë Fshat (2.08%), SHA UK Rubik (26.48%), SHA UK Fushë Arrëz (33.33%), SHA UK Fushë Krujë (34.1%), SHA UK Bashkia Pukë (38.73%) dhe SHA UK Libohovë (48.73%).

Përfundime

Gjendja në sistemin e kanalizimeve vazhdon të jetë pothuaj e njëjtë. Edhe gjatë këtij viti shoqëritë nuk kanë kryer investime për zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve dhe për rrjedhojë nuk ka ndryshuar shkalla e mbulimit me këtë shërbim në sektor. Përqindja e mbulimit në shkallë vendi vazhdon të jetë 51%. Përsa i përket trajtimit të ujërave të ndotura vërehet disa probleme. Impianti trajtimit në Vlorë megjithëse ka 7 vjet që është ndërtuar akoma nuk funksionon. Impiantet për zonën Lezhë-Shëngjin dhe Sarandë akoma nuk kanë filluar së funksionuari kjo si rezultat i mos koordinimit në kohë të punimeve të ndërtimit të impianteve dhe i rrjetit të kanalizimeve që do të dërgojnë ujrë të ndotura në këto impiante.

3.10 Perceptimi rregullator

ERRU në zbatim të Ligjit 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura, i ndryshuar, ka për qëllim të garantojë dhe të mbrojë interesat publike si dhe krijojë një mjedis transparent ligjor dhe rregullator. Treguesi “Perceptimi rregullator” vlerëson shkallën me të cilën shoqëritë UK përmbushin dhe mbështesin kërkesat e ERRU në arritjen e objektivave të misionit rregullator. Për të bërë vlerësim e këtij treguesi janë marrë në konsiderarë katër aspekte kryesore që tregojnë se si shoqëritë ujësjellës kanalizime kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe sa pjesmarrës aktivë kanë qënë në këtë proces.

Vlerësimi i përgjithshëm maksimal është 100 pikë. Secili prej aspekteve të më poshtme vlerësohet maksimumi me 25 pikë:

- Liçensimi: kur shoqëria operon me liçencë të vlefshme nga ERRU;
- Tarifë e miratuar nga ERRU: kur shoqëria operon me tarifë të miratuar nga ERRU;
- Pagesat rregullatore: kur shoqëria ka kryer pagesat rregullatore kundrejt ERRU në kohë dhe në masë të plotë (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve nëse pagesat nuk janë kryer plotësisht);
- Komunikimi me ERRU: nëse shoqëria u është përgjigjur informacioneve, kërkesave apo njoftimeve të ndryshme bërë nga ERRU (maksimumi 25 pikë kur të gjitha përgjigjet janë dhënë në kohë dhe të plota).

Tabela 6 liston pikët e dhëna 58 shoqërive për secilin nga këto aspekte, duke i renditur ato në grupet përkatëse sipas pikëve të përgjithshme të marra për këtë tregues.

Shoqëritë			Liçencimi	Tarifë e miratuar nga ERRU	Pagesat rregullatore	Komunikimi me ERRU	PIKËT TOTALE
Grupi 1	UK	Korçë	25	25	25	20	95
	UK	Shkodër	25	25	22	15	87
	UK	Berat-Kuçovë	25	25	11	20	81
	UK	Tiranë	25	25	3	20	73
	UK	Durrës	25	25	1	17	68
	UK	Sarandë	25	25	5	12	67
	U	Vlorë	25	25	1	15	66
	UK	Elber sh.p.k	25	25	-	13	63
	U	Elbasan Fshat	25	25	-	10	60
	UK	Kavajë	25	25	-	10	60
	UK	Fier	15	25	3	8	51
Grupi 2	UK	Gjirokastër	25	25	25	20	95
	UK	Lezhë	25	25	17	20	87
	U	Përmet	25	25	25	10	85
	UK	Lushnjë	25	25	10	18	78
	U	Peshkopi	25	25	6	18	74
	U	Kurbin	25	25	-	17	67
	UK	Librazhd	25	25	5	10	65
	UK	Pogradec	25	25	4	10	64
	UK	Burrel	25	25	1	13	64
	U	Tepelenë	25	25	5	8	63
	UK	Krujë	25	25	-	8	58
	UK	Rrogozhinë	25	25	-	8	58
	U	Lushnjë Fshat	25	25	-	4	54
	U	Gramsh	15	25	-	13	53
	U	Korçë Fshat	25	-	-	13	38
	U	Patos	15	-	-	13	28
	UK	Kukës	5	15	-	17	37
	UK	Mallakastër	-	-	-	17	17

Grupi 3	U	Bulqizë	25	25	21	20	91
	UK	Ersekë	25	25	25	15	90
	U	Orikum	25	25	25	8	83
	U	Bilisht	10	25	25	10	70
	U	Tropojë	25	25	-	18	68
	UK	Rubik	25	25	8	10	68
	U	Ura Vajgurore	25	25	-	17	67
	U	Delvinë	25	25	-	15	65
	UK	Bashkia Pukë	25	25	-	15	65
	U	Gjirokastrë Fshat	25	25	-	13	63
	UK	Krastë	25	25	-	13	63
	U	Selenicë	25	25	-	13	63
	U	Polican	25	25	-	10	60
	UK	Fushë Krujë	25	15	-	8	48
	U	Shkodër Fshat	25	25	-	8	58
	U	Çorovodë	25	25	-	4	54
	UK	Peqin	10	25	-	13	48
	UK	Mirditë	5	25	-	15	45
	U	Divjakë	25	-	-	13	38
	UK	Libohovë	25	-	-	13	38
	U	Vau i Dejës	25	-	-	10	35
	UK	Himarë	25	-	-	5	30
	U	Novoselë	25	-	-	5	30
	U	Malësi e Madhe	25	-	-	-	25
	U	Has	10	-	-	10	20
	UK	Pukë Fshat	-	-	-	13	13
	UK	Fushë Arrëz	5	-	-	5	10
	U	Këlcyrë	-	-	-	5	5
	UK	Bradashesh	-	-	-	-	0

Tabela 6. Perceptimi Rregullator: Pikët e performancës të arritura sipas grupeve

Liçencimi

Sipas legjislacionit në fuqi çdo operator që kryen shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura duhet të pajiset nga ERRU me liçencën përkatëse. Liçenca është instrumenti kryesor që garanton konsumatorët se operatori ka aftësinë për të ofruar shërbim sipas standardeve të miratuara. Shoqëria është e detyruar të respektojë kushtet e liçences, të cilat janë objekt i monitorimit të ERRU. Për këtë arsye, ERRU ka bërë përpjekje të vazhdueshme për nxitjen e njësive të qeverisjes vendore që ato të ofrojnë shërbime përmes shoqërive të liçensuara. Rezultatet tregojnë se sektori është duke performuar mirë në këtë drejtim.

Proçesi i liçencimit përfshin jo vetëm paisjen me liçencë të shoqëritë palicensuara por edhe rinovimin e liçencës, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Me përjashtim të Sha U Këlcyrë dhe SHA UK Pukë Fshat që akoma vazhdojnë të operojnë pa liçencë, SHA UK Mallakastër, SHA UK Fushë Arrëz, Sha U Bilisht, SHAUK Fier, SHAUK Gramsh, SHA U Has, SHA UK Kukës, SHA UK Mirditë, SHA U Patos, SHA UK Peqin janë shoqëri të cilave i'u ka mbaruar afati i vlefshmërisë së liçencës në vitin 2013. Këto shoqëri nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për rinovimin e liçencës në kohë. ERRU në vazhdimësi ka monitoruar situatën e liçensimit në sektor dhe është përpjekur të sjellë në vëmendjen e shoqërive respektimin e kushteve të liçensimit. Eksperienca e deritanishme ka treguar se disa shoqëri, kryesisht të vogla, nuk mund të paisen me liçencë pasi nuk përmbushin kërkesat ligjore të liçensimit. ERRU është duke bërë përpjekje për të gjetur zgjidhjet e duhura për problemet e konstatuara. Në të ardhmen ERRU do të intensifikojë punën për monitorim e zbatimit të kushteve të liçensës nga të liçencuarit. Kur rregullatori do të konkludojë se i liçensuari nuk ka zbatuar Kushtet e Liçencës do të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

Tarifat e miratuara nga ERRU

Në vitin 2013 për 45 shoqëri faturimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve kryhet sipas tarifave të miratuara nga ERRU. Këtë vit edhe SHA U Bulqizë aplikoi për herë të parë tarifa të miratuara nga ERRU. SHA U Korçë Fshat, SHA U Patos, SHA UK Mallakastër, ` SHA U Has, SHA U Vau i Dejës, SHA U Malësia e Madhe, SHA UK Libohovë, SHA U Divjakë, SHA UK Fushë Arrëz, SHA U Këlcyrë, dhe SHA UK Pukë Fshat dhe SHA UK Himarë operojnë me tarifa të pamiratuara nga ERRU. Enti Rregullator do të vazhdojë të nxisë këto shoqëri për të bërë të mundur operimin e tyre brenda kuadrit ligjor. së pari për tu liçensuar pasi vetëm shoqëritë e liçencuar nga ERRU për kryerjen e shërbimeve mund të aplikojë për miratimin e tarifave. Megjithatë brenda grupit të shoqërive që ende aplikojnë tarifa të pamiratuara nga ERRU, një pjesë e tyre disponon një liçencë të vlefshme. ERRU do të vazhdojë të nxisë këto shoqëri për të paraqitur aplikimet për miratimin e tarifave. Në zbatim të Metodologjisë "Për Vendosjen e Tarifave", miratimi i tarifave për shoqëritë që aplikojnë për herë të parë bëhet me procedurë të përsheptuar.

Pagesat rregullatore

Pagesat e rregullimit janë detyrime të operatorëve që operojnë në sektorin UK ndaj ERRU, të përcaktuara në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 dhe të nënshkruara prej palëve në kontratën për aplikimin e tarifave të shërbimit.

Ligji ka përcaktuar se pagesat e rregullimit të operatorëve janë burim financimi për ERRU shpenzimet vjetore të të cilit miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Me keqardhje ERRU konstaton se, në drejtim të shlyerjes së këtyre detyrimeve ligjore e kontraktuale, përgjithësisht sjellja e operatorëve prej disa viteve karakterizohet nga një moskorrektësi dhe neglizhencë e theksuar .

Situata e likujdimit të pagesave rregullatore në vitin 2013, paraqitet aspak e mirë, duke u kthyer në një shqetësim të vazhdueshëm për rregullatorin. Në vazhdimësi gjatë vitit problemi është shqyrtuar dhe analizuar herëpas herë, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me operatorët, është analizuar ngarkesa e gjithësecilit. Në perfundim të këtyre analizave ka rezultuar se:

- rregullatori ka zbatuar parimin e barazisë midis operatorëve në vendosjen e pagesave rregullatore,
- arkëtimet e realizuara nga pagesat e rregullimit, prej disa viteve mbulojnë vetëm 70% të shpenzime operative vjetore të Entit,
- moslikujdimi i detyrimeve në përputhje me kontratën përveçse është shkelje ligjore, rëndon gjithnjë e më shumë barrën e operatorëve,
- për çdo klient pagesa rregulltore vjetore e kontraktuar është afro 103 lekë, ndërsa pagesa e likuduar 62.4 lekë.

Shoqëritë që kanë likujduar pagesën rregullatore në vitin 2013, në përputhje të plotë me kontratën, janë: SHA UK Korçë, SHA UK Gjirokastrë, SHA U Permet, SHA U Orikum dhe SHA U Bilisht. Gjithashtu, Sha UK Shkodër, SHA UK Lezhë, SHA U Bulqizë vlerësohen pozitivisht në këtë drejtim, megjithëse nuk kanë arritur të paguajnë plotësisht pagesën rregullatore, pasi në vite ato kanë respektuar detyrimet kontraktuale.

Gjate këtij viti evidentohen shoqëri të cilat pamvarësisht pagesave të kryera, nuk kanë shlyer asnjë detyrim për llogari të vitit, të tilla janë:

SHA UK Berat - Kuçovë, SHA UK Durrës, SHA UK Fier, SHA U Vlorë, SHA UK Kavajë, SHA UK Sarandë, SHA UK Burrel, SHA UK Krujë, SHA U Tepelenë, SHA UK Tirane SHA U Lushnjë Fshat, etj

ERRU në vijimësi ka kërkuar dhe pritur mirëkuptimin e shoqërive për shlyerjen e pagesave rregullatore, por në situatën e krijuar është i vendosur të ndjekë të gjitha rrugët ligjore deri në likujdimin e total të detyrimeve.

Komunikimi me ERRU

ERRU nëpërmjet politikës së tij të bashkëpunimit dhe konsultimit në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentave rregullatore, ka bërë të mundur që shoqëritë të ndërgjegjësohen dhe të vlerësojnë rolin e tij në rregullimin e sektorit. Pjesa më e madhe e shoqërive kanë qënë pjesëmarrës aktive në këtë proces. ERRU edhe gjatë vitit 2013 ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha shoqëritë si nëpërmjet kërkesave për informacoin, takimeve e konsultimeve për diskutimin e çështjeve të ndryshme. Bashkëpunimi dhe mirekuptimi për tju pergjigjur kerkesave të ERRU është baza mbi të cilën është bërë edhe vlerësimi përse i përket komunikimit me ERRU. Në këtë drejtim jo të gjitha shoqëritë kanë patur komunikim shume të mirë. Me pikë maksimale nuk është vlerësuar asnjë shoqëri. SHA UK Bulqize është shoqëria që merr vlerësimin më të mirë me 21 nga 25 pikë të mundshme.

Ndërsa shoqëritë si: Sha U Fushë Arrëz, Sha U Malësi e Madhe SHA UK Himarë kanë treguar interesin më të dobët ndaj kërkesave të Rregullatorit.

Përfundime

Rezultatet e analizës së më sipërme tregojnë se ndonëse ka vend për disa rregullime në lidhje me liçensimin dhe aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU, sektori ujësjellës kanalizime është duke funksionuar gjithmonë e më shumë brenda kuadrit rregullator. Për dy dy aspektet e tjera ka vend për përmirësim. Gjate vitit 2013 situata në lidhje me permbushjen e detyrimeve kontraktuale për likuidimin e pagesave rregullatore është përkeqësuar. Numri i shoqërive që nuk kanë shlyer detyrimet për pagesat rregullatore është rritur. Rritja e vlerës së papaguar vit pas viti rrit krijon probleme në likuidim. Kur flasim për detyrim të papaguar nenkuptojmë jo vetëm detyrimin e vitit 2013.

ERRU vlerëson korrektësinë dhe përpjekjet e të gjitha shoqërive për të patur patur një bashkëpunim sa më të mirë. Por edhe komunikimin me ERRU ndonëse vlerësohet pozitivisht, nuk ka patur të njëjtin vlerësim nga të gjitha shoqëritë. Asnje shoqëri nuk i është përgjigjur të gjithë kërkesave të ERRU. Për ato shoqëri, që për arsye objektive nuk plotësojnë kërkesat formale të liçencimit dhe miratimit të mund të tarifave dhe nuk kanë vlerësim të mirë të treguesit të perceptimit rregullator, përmirësimi i performacën së këtij treguesi mund të vijë duke rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me ERRU. Shoqëritë UK duhet të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me përgjegjësitë që ato kanë për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga si për tju përgjigjur në kohë dhe me cillësi kërkesave të ERRU. Performuesi më i mirë në vitin 2013 për sa i përket treguesit “Perceptimi rregullator” është Sha UK Korçë, shëmbullin e të cilit duhet të ndiqet edhe nga shoqëritë e tjera.



4

Renditja e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime sipas performancës për vitin 2013

Pas analizës së performancës individuale të secilës shoqëri për çdo tregues, në këtë kapitull pasqyrohet vlerësimi i performancës së përgjithshme bazuar në totalin e pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i çdo treguesi kryesor të performancës. Bazuar në këtë vlerësim shoqëritë ujësjiellës kanalizime janë renditur sipas performancës së tyre përgjithshme.

Për të tretin vit radhazi ERRU ka përdorur të njëjtën mënyrë vlerësimi të performancës së shoqërive. Shoqëritë UK tashmë të familjarizuara me këtë mënyrë vlerësimi shikojnë pozicionimin e tyre në renditje, krahasojnë rezultatet tyre me atë të shoqërive të tjera. Gjithashtu ato mund të krahasojnë rezultatet e performancës së tyre të përgjithshme në vite. Kjo mënyrë vlerësimi si dhe publikimit i përvitshëm të rezultateve i krijon mundësi informimi jo vetëm për ata që janë ekspertë të fushës por edhe për një publik më të gjerë.

ERRU bazuar në rezultatet e performancës së përgjithshme ka përcaktuar performuesit më të mirë dhe më të dobët si dhe ato që kanë patur ecurinë më të mirë.

Analiza e performancës është bazuar në të dhënat e raportuara nga shoqëritë. Cilësia e të dhënave të raportuara luan një rol të rëndësishëm në rezultatet e vlerësimit. Në vitin 2013 ERRU nuk ka mundur të vlerësojë performancën e tre shoqërive të cilat nuk kanë raportuar të dhëna. Problemet e konstatuara si në raportimin e të dhënave, pasaktësitë apo mospërputhjet në raportim shtrojnë para rregullatorit domozdoshmërinë për të intensifikuar punën në lidhje me sasinë, cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. ERRU në të ardhmen do të punojë me të gjitha shoqëritë për të bërë të mundur raportimin e të dhënave nga të gjitha shoqëritë si dhe për të rritur saktësinë e tyre.

Renditja e shoqërive sipas performancës së përgjithshme

Përpara se të shikojmë se si janë renditur shoqëritë bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës së përgjithshme, shkurtimisht është paraqitur mënyra e vlerësimit.

Shoqëritë janë renditur sipas pikëve totale të performancës të llogaritura mbi bazën e vlerësimit të 8 nga 10 TKP. Secili prej treguesve kryesorë të performancës ka një peshë specifike të caktuar që tregon rëndësinë relative të tij. Maksimumi i pikëve që mund të arrihen është 100 pikë. Çdo TKP vlerësohet me një rezultat maksimal nga 5 deri në 20 pikë, në varësi të peshës specifike që i është caktuar dhe ka kufijtë e tij maksimalë dhe minimalë të performancës. Performanca e mirë konsiderohen arritjet e shoqërisë në nivelin e objektivave të vendosur nga ERRU.. Përgjithësisht, nëse performanca është nën këtë objektiv, me qëllim inkurajimin dhe vlerësimin hap pas hapi të përmirësimeve vlerësimi bëhet për vetëm një përqindje të pikëve në dispozicion. Për disa tregues si eficientia e stafit, uji pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm performanca në nivelin apo nën nivelin minimal të pranueshëm të objektivave të vendosur nga ERRU vlerësohet me zero pikë. Sistemi i pikësimit paraqitet në tabelën 7.

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivi i vendosur për performancën		Pesha specifike	Pikët maksimale
		Pikë të plota	0 pikë	Totali 100%	
1 - Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	0%	15%	15
2 - Mbulimi i Kostos Totale		Nuk është përfshirë në vendosjen e pikëve			
3 - Norma e Arkëtimit		≥ 82%	≤ 60%	20%	20
4- Eficientia e Stafit (Staf për 1000 lidhje)	Grupi 1	≤ 4	≥ 6	5%	5
	Grupi 2	≤ 6	≥ 10		
	Grupi 3	≤ 10	≥ 15		
5 - Uji pa të Ardhura		≤ 30%	≥ 50%	15%	15
6 - Niveli I Matjes		≥ 85%	0%	15%	15
7 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 ore/ditë	0%	10%	10
8 -Cilësia e Ujit të Pijshëm		Nuk është përfshirë në vendosjen e pikëve			
9- Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	0%	5%	5
10- Perceptimi Rregullator		25 pikë	0 pikë	5%	5

Tabela 7. Sistemi i renditjes së shoqërive: Treguesit Kryesorë të Performancës, Objektivat , Pesha specifike për çdo TPK, pikët

Rezultatet e renditjes për vitin 2013

Në tabelën e mëposhtëme 55 shoqëritë e marra në analizë janë renditur sipas pikëve të rezultatit të përgjithshëm të performancës. Siç edhe është sqaruar më parë, në këtë vlerësim nuk bëjnë pjesë tre shoqëri, SHA UK Himarë, SHA U Novoselë dhe Bradashesh të cilat nuk kanë raportuar të dhëna gjatë vitit 2013.

Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes	Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	UK	Korçë	99.40	30	U	Tepelenë	53.59
2	UK	Librazhd	96.81	31	UK	Berat - Kuçovë	51.87
3	UK	Pogradec	86.81	32	UK	Kukës	51.43
4	U	Përmet	82.05	33	U	Bulqizë	50.86
5	UK	Rubik	78.96	34	UK	Peqin	50.71
6	UK	Burrel	77.70	35	UK	Mallakastër	50.62
7	UK	Tiranë	77.18	36	UK	Shkodër	50.59
8	U	Delvinë	76.72	37	U	Peshkopi	48.36
9	U	Elbasan Fshat	74.80	38	UK	Durrës	48.14
10	UK	Ersekë	73.60	39	U	Këlcyre	45.69
11	U	Gramsh	71.02	40	U	Poliçan	45.27
12	UK	Bashkia Pukë	70.01	41	U	Vlorë	38.94
13	U	Divjakë	69.87	42	UK	Selenicë	38.88
14	UK	Lezhë	67.79	43	U	Gjirokastrë Fshat	37.63
15	U	Bilisht	67.08	44	UK	Pukë Fshat	37.29
16	UK	Lushnjë	65.97	45	UK	Mirditë	36.95
17	UK	Rrogozhinë	65.71	46	U	Patos	34.62
18	UK	Elber sh.p.k	65.12	47	U	Shkodër Fshat	33.69
19	UK	Sarandë	65.07	48	U	Tropojë	32.42
20	UK	Kavajë	63.25	49	UK	Fushë Arrëz	31.69
21	U	Lushnjë Fshat	62.34	50	U	Has	31.13
22	U	Ura Vajgurore	60.49	51	U	Kurbin	27.50
23	UK	Libohovë	60.46	52	U	Vau i Dejës	25.38
24	UK	Fushë Krujë	59.91	53	U	Orikum	24.92
25	UK	Krastë	59.56	54	U	Çorovodë	22.66
26	UK	Fier	57.22	55	U	Malësi e Madhe	19.62
27	UK	Gjirokastrë	56.54	56	UK	Bradashesh	-
28	U	Korçë Fshat	56.44	57	UK	Himarë	-
29	UK	Krujë	55.93	58	U	Novoselë	-

Tabela 8. Tabela e renditjes së shoqërive

Performuesit më të mirë

Në bazë të renditjes në secilin grup, shoqëritë më rezultatet më të mira janë ato që renditëditen në dy vendet e para. Performuesit më të mirë në secilin grup vlerësohen me çmim nga ERRU. Pavarësisht nga rezultati, çmimi mund të merret vetëm nga shoqëritë të cilat operojnë në përputhje me kuadrin rregullator, pra kanë një licensë të vlefshme dhe tarifa të miratuara nga ERRU. Për vitin 2013, shoqëritë më rezultatet më të mira janë paraqitur në tabelen 9.

Renditja	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	Korçë	99.40	Librazhd	96.81	Rubik	78.96
2	Tiranë	77.18	Pogradec	86.81	Delvinë	76.72

Tabela 9. Performuesit më të mirë në Renditjen e Shoqërive për Vitin 2013

Në grupin e parë, SHA UK Korçë është shoqëria me performancën më të mirë. Kjo shoqëri kryeson edhe listën e renditjes së shoqërive sipas performancës së përgjithshme për të tretin vit radhazi. Diferenca nga maksimumi i pikëve është vetëm 0.6 pikë. SHA UK Tiranë është renditur në vendin e dytë por me një diferencë prej më shumë se 20 pikë nga vendi i parë. Në grupin 2, e para renditet SHA UK Librazhd, e ndjekur nga SHA UK Pogradec e pozicionuar në vendin e dytë. Në grupin 3, sipas pikëve të vlerësimit të performances së përgjithshme dallohen për performancë të mirë renditet e para Shoqëria Rubik dhe e dyta me një diferencë të vogël (rreth 3 pikë) shoqëria Delvinë.

Shoqëritë me ecurinë më të mirë në kohë

Krahas vlerësimit për performuesit më të mirë, vlerësim i cili bazohet në rezultatet e arritura në vitin 2013, ERRU vlerëson me çmim edhe shoqëritë që bëjnë përpjekje për të përmirësuar performancën e tyre. Ecuria e mirë e punës së tyre ka sjellë më shumë pikë të grumbulluara krahasuar me një vit më parë.

Ndonëse shumë shoqëri e kanë të vështirë të arrijnë në vendet e para të renditjes edhe për shkak të faktorëve të jashtëm, organizimit apo gjendjes së sistemit të tyre me punën e tyre kanë bërë progres krahasuar me një vit më parë. Për të vlerësuar këto ndryshime të performancës pikët e vlerësimi i performancës së përgjithshme në vitin 2013 janë krahasuar me ato të vitit 2012. Për çdo grup shoqëria që ka patur progresin më të mirë është vlerësuar me çmimin për ecurinë më të mirë. Tabela 10 më poshtë paraqet “shoqëritë me ecurinë më të mirë” në secilin nga tre grupet.

Shoqëria		Renditja në grup	Pikët e renditjes 2012	Pikët e renditjes 2013	Ndryshimi në pikët e renditjes
Grupi 1	Shkodër	36	47.89	50.59	+ 3.17
Grupi 2	Burrel	6	67.39	70.70	+ 10.31
Grupi 3	Ersekë	10	66.29	73.60	+ 7.30

Tabela 10. Shoqëritë me ecurinë më të mirë në renditje për vitin 2013

Këto shoqëri ndonëse nuk janë renditur në vendet e para të vlerësimit të përgjithshëm të performancës, kanë bërë progresin më të mirë krahasuar me një vit më parë. Në grupin e parë SHA UK Shkodër e renditur në vendin e 36-të, dallohet për ecurinë më të mirë me 3.17 pikë më shumë se sa në vitin 2012. Në grupin dytë, SHA UK Burrel ka ecurinë më të mirë me 10.31 pikë më shumë sesa një vit më parë, megjithëse renditet në vendin e 6-të. Në grupin e tretë ecurinë më të mirë e ka shënuar SHA UK Ersekë me 7.30 pikë më shumë krahasuar me vitin 2012.

Këtë vit Enti rregullator ka vendosur të japë edhe dy çmime të veçanta si vlerësim i kontributit të veçantë në performancën e sektorit ujësjellës kanalizime. Ky vlerësim vjen si mirënjohje e përpjekjeve menaxheriale për përmirësimin mjaft të dukshëm të shoqërisë UK dhe shërbimit ndaj konsumatorit apo si një mbështetje teknike e vyer në hartimin e strategjive, instrumentave dhe mjeteve në tërësi për të rritur në mënyrë të qëndrueshme sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri.

Fatmir Shehu - Drejtor i SHA UK Berat - Kuçovë

Hermann Plumm – Drejtor i Projektit të GIZ “Reforma në Sektorin e Ujit në Shqipëri”

Përgëzime dhe perspektiva

ERRU nëpërmjet këtij vlerësimi i përgëzon të gjitha shoqëritë që në vitin 2013 kanë arritur të dallohen për performacë të mirë si dhe ato që janë përpjekur të përmirësojnë performancën e tyre duke sjellë ndryshime të rëndësishme në ecurinë e tyre. Për këto shoqëri është e rëndësishme të vazhdojnë të punojnë për t'i ruajtur dhe çuar më përpara rezultatet e arritura.

Këto shoqëri janë një shembull i mirë edhe për shoqëritë e tjera. Eksperiencat e më të mirëve tregojnë se një menaxhim i mirë sjell për konsumatorët edhe një shërbim më të mirë. ERRU do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë të gjitha shoqëritë në përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve.



5

Tema e veçantë e vitit 2013: Bilanci i ujit të pijshëm

Një nga problemet më serioze në sektorin UK është niveli i lartë i ujit pa të ardhura i cili është i lidhur drejtpërsëdrejti me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive ujësjellës kanalizime dhe cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit. Niveli i lartë i humbjeve jep ndikim negativ në situatën financiare të shoqërisë pasi rrit kostot duke qenë se prodhohet më shumë ujë se sa nevojitet. Gjithashtu, nuk identifikohen burime potenciale të ardhurash nga përdoruesit e paligjshëm që nuk u faturohet ujë. Nga ana tjetër niveli i lartë i humbjeve ka ndikim në cilësinë e ujit të pijshëm dhe në furnizimin e vazhdueshëm me ujë për konsumatorët. Siç vihet re nga analiza e performancës për 3 vitet e fundit, ky tregues është përkeqësuar duke i'u larguar më tepër objektivave të vendosura.

Përveç kësaj Shoqëritë UK nuk kanë një bilanc të unifikuar dhe të mirëfilltë uji. Disa shoqëri llogaritnin vetëm sasinë e ujit të prodhuar, që në pjesën më të madhe të tyre nuk është i matur, por i vlerësuar si dhe sasinë e ujit të faturuar, disa që kanë projekte me donatore në sektorin UK, përdorin tabelën e bilancit të IWA, ndërsa të tjerat kanë tabelat e tyre të llogaritjes. Në kuadër të këtyre problematikave në sektor, ku nuk ka një informacion të mirëfilltë mbi humbjet e ujit dhe të dhëna të unifikuara në një mënyrë raportimi nga të gjitha shoqëritë, nga ERRU u ndërmor një studim në të gjitha shoqëritë UK, mbi raportimin e të dhënave të detajuara të bilancit të ujit.

Tabela e Bilancit të Ujit e dërguar nga ERRU për t'u plotësuar nga shoqëritë, kryesisht përmban në vetvete informacione në lidhje me:

- Sasinë e ujit të prodhuar dhe të furnizuar në sistemin e furnizimit të zonës së shërbimit;
- Sasinë e ujit të humbur për shkak të problemeve teknike të sistemit apo matësive të ujit;
- Sasinë e ujit të humbur për shkak të lidhjeve ilegale apo keqadministrimit të sistemit;
- Sasinë e ujit të furnizuar tek klientët;
- Sasinë e Ujit të përdorur për qëllime publike dhe për institucione të veçanta.

Kjo tabelë u shoqërua me një manual shpjegues mbi të gjithë komponentët përbërës të Bilancit të Ujit si dhe shpjegime për llogaritjen e komponentëve të bilancit.

Rëndësia e bilancit të ujit

Bilanci i Ujit, si një model i unifikuar për të gjithë shoqëritë:

- Në radhë të parë i shërben Operatorëve për të vërejtur dhe kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme problematiken që ndodh gjatë administrimit të sistemit të furnizimit me ujë në pjesë të ndryshme të tij, në mënyrë që të gjejë zgjidhjet përkatëse në një kohë sa më të shkurtër.
- Duke qenë se humbjet teknike janë direkt të lidhura me investimet, operatori krahas investimeve të mundshme, mund të fokusohet në drejtim të reduktimit të humbjeve administrative, gjë që gjithsesi do të çojnë në uljen e nivelit të ujit pa të ardhura në total. Për të realizuar këtë, Operatorët e Ujit duhet të synojnë drejt matjeve të vazhdueshme të sive të ujit që kërkojnë gjatë plotësimit të këtij Bilanci nëpërmjet instalimit të matësve të ujit në vendet e prodhimit të tij, matësat zonale, etj
- Njëkohësisht, Bilanci i Ujit i plotësuar nga Operatorët do të jetë një instrument që do ti shërbejë ERRU-së, që të ketë një informacion më të detajuar në lidhje me ujin pa të ardhura, në mënyrë që të ketë të dhëna më të sakta në momentin e një aplikimi për tarifë dhe në përcaktimin e objektivave të shoqërisë, si dhe pronarëve (pushteteve lokale) dhe aktorëve të tjerë të interesuar për të monitoruar performancën dhe cilësinë e shërbimit të Operatorëve të Ujit.

Analiza e shoqërive UK mbi të dhënat e Bilanci të Ujit

Baza fillestare e analizës së bilancit, ishte verifikimi i të dhënave mbi plotësimin e "Balanceve të Ujit" të dërguara nga shoqëritë UK, sidomos ndarja e humbjeve të përgjithshme në humbje të dukshme dhe humbje teknike. Nga ky verifikim u vu re që shumë shoqëri nuk i kanë plotësuar me përgjegjshmëri këto të dhëna. Në shumë prej tyre, vlera e humbjeve reale të raportuara nuk përkon me gjendjen teknike të sistemeve të ujësjellësit që ato kanë e për rrjedhojë dhe të dhënat e raportuara për humbjet administrative të shoqërive nuk janë të sakta. Kjo problematikë është vënë re në të tre grupet e shoqërive, por më e theksuar ka qenë në shoqëritë e grupit të dytë dhe të tretë. Për verifikimin e të dhënave, u bë dhe një krahasim i tyre me ato të dërguara tek njësia e monitorimit pranë DPUK, për tregues si popullsia në juridiksion, popullsia në shërbim, niveli i humbjeve dhe sasia e ujit të prodhuar. Nga ky krahasim rezultuan diferenca të ndjeshme dhe doli dhe njëherë në pah që shoqëritë kanë mjaft probleme me bazën e të dhënave si dhe me mënyrën sesi i llogarisin dhe i përpunojnë ato.

Analiza e detajuar e të dhënave të Bilancit të Ujit për çdo shoqëri, u bazua kryesisht në volumin e humbjeve të përgjithshme si dhe në ato reale e të dukshme, duke u fokusuar më shumë në humbjet e dukshme. Në detaj u vlerësuan shoqëritë e grupit të parë dhe të dytë, duke qenë dhe shoqëritë të cilat mbulojnë pjesën më të madhe të territorit dhe zënë përqindjen më të madhe të humbjeve të përgjithshme. Pavarësisht problematikes me mbajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre, nga kjo analize e detajuar doli që pjesën më të madhe të humbjeve të ujit shoqëritë e kanë humbje të dukshme dhe kjo tregon se humbjet vijnë nga një menaxhim jo i mirë i këtyre shoqërive. Mesatarja e humbjeve të përgjithshme për vitin 2013 për grupin e parë është rreth 70% nga kjo 46 % janë humbje të dukshme dhe 24 % janë humbje reale. Në grupin e dytë mesatarja e humbjeve të përgjithshme shkon në 64% nga kjo gjysma janë humbje të dukshme dhe pjesa tjetër janë humbje reale.

Rezultate dhe Rekomandime

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura nga vetë shoqëritë mbi Bilancin e Ujit, kryesisht u vunë re problemet e mëposhtme:

- Totali i humbjeve është shumë i lartë, çuditërisht shoqëritë e grupit të parë (të mëdhatë) kanë humbje më të larta sesa shoqëritë e mesme (grupi II);
- Pjesa më e madhe e humbjeve (rreth 50%) janë humbje që vijnë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, ndërsa pjesa tjetër 20 – 24% janë humbje reale (ose teknike).
- Ndërmarrjet kanë probleme në kuptimin e koncepteve bazike teknike siç janë elementët përbërës të bilancit të ujit;
- Raportimi i të dhënave në lidhje me nëntregues të bilancit të ujit si: uji i prodhuar, i shpërndarë tek klientët, konsumi, zona e mbulimit me shërbim, etj nga vetë shoqëritë si pjesë e këtij bilanci uji ndryshojnë dukshëm në krahasim me ato çfarë raportojnë shoqëritë tek NjMB;
- Shoqëritë shfaqën pasaktësi në plotësimin e tabelës së bilancit të ujit, sidomos në paraqitjen e saktë të ndarjes së humbjeve të përgjithshme, në humbje të dukshme dhe reale. Kjo pasaktësi vihet re sidomos në shoqëritë e grupit të dytë dhe të tretë.

Faktori kryesor që rëndon më tepër situatën e humbjeve është pasaktësia e të dhënave të raportuara, e cila nuk mundëson një situatë reale dhe për pasojë gjykim real mbi to. Kështu që, mbi të gjitha, shoqëritë duhet të punojnë me përgjegjshmëri për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të sakta e reale, për të krijuar një pasqyrë sa më të qartë të situatës teknike e menaxhuese të shoqërisë së tyre, e më pas në gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme për përmirësimin e saj.

Për ato shoqëri ku mungon matja e prodhimit është e vështirë të hartohet një bilanc uji me shifra të sakta e për rrjedhojë edhe niveli i ujit pa të ardhura bëhet një tregues i vlerësuar. Vendosja e matësave në pikat e prodhimit, matësave zonale dhe atyre për klientët individualë, është një detyrim ligjor të cilin shoqëritë duhet ta zbatojnë. Ky hap mjaft i rëndësishëm bën të mundur jo vetëm hartimin e saktë të bilanceve të ujit dhe evidentimin e saktë të humbjeve sipas llojit, por dhe hartimin e plan veprimeve konkrete për reduktimin e tyre.

Nga ana tjetër, zëvendësimi i faturimit me tarifave të sheshta/afrofe, me faturimin real volumetrik, do të ulte nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive. Konsumatorët, sidomos ata familjare po fillojnë të kuptojnë avantazhin e matjes së konsumit pasi kështu janë në gjendje të vlerësojnë dhe kontrollojnë shpenzimet e tyre, kështu që pjesa kryesore e punës për instalimin total të matësave tashmë i takon shoqërive.

Gjithashtu identifikimi, ndërprerja ose legalizimi i lidhjeve të paligjshme përbën një hap tjetër për përmirësimin e situatës si dhe ndihmon jo vetëm në menaxhimin e drejtë të volumit të ujit të prodhuar por dhe në rritjen e nivelit të të ardhurave.

Reduktimi i humbjeve të dukshme duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve. Operatorët duhet të kenë plane të qarta veprimi përsa i përket angazhimeve konkrete për reduktimin e humbjeve të dukshme të ujit. Me një llogaritje të thjeshtë mesatare, nëse shoqëritë e grupit të parë dhe të dytë që mbulojnë pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë do të reduktonin, duke vlerësuar realisht të dhënat e tyre dhe duke marrë disa nga masat e përmendura më sipër, humbjet e dukshme vetëm me 50%, niveli i humbjeve në total do ulej me rreth 13 %, pra nga 68% do të shkonte në 55%.

Bilanci i Ujit do të jetë një iniciative periodike e ERRU-së që do të vazhdojë jo vetëm gjatë vitit 2014, por dhe më tej, duke u kthyer tashmë në një raportim periodik. Nëse gjatë vitit 2013, si iniciative e parë, bilanci i ujit u analizua kryesisht për të nxjerre në pah problematikat e shoqërive jo vetëm me humbjet, por dhe me mënyrën sesi mbahen apo raportohen të dhënat, në vazhdim ky bilanc do të vlerësohet e analizohet më në detaje. Për këtë arsye Bilanci i Ujit u miratua me vendim të KKRR nr. 46 datë 27.12.2013, si një akt nënligjor i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë UK.

Llogaritjet e bilancit të ujit në vijim do të paraqesin një analizë të detajuar të nivelit të përgjithshëm të matjes, të konsumit, të humbjeve si dhe klasifikimin e tyre në mënyrë që të vërehen dhe kontrollohen periodikisht problematikat që ndodhin gjatë administrimit të sistemit të furnizimit me ujë, në pjesë të ndryshme të tij. Bazuar në këtë analizë ERRU do të monitorojë periodikisht objektivat e vendosura për kompanitë, duke marrë masat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe duke vendosur dhe penalitete për ato shoqëri që nuk i respektojnë ato.

UK	Kavajë	60.91
UK	Korçë	103.00
UK	Elbasan Fshat	72.90
UK	Sarandë	109.88
UK	Pogradec	98.22
UK	Lushnjë	54.42
UK	Gjirokastër	96.46
UK	Lezhë	33.00



6

Konkluzione dhe perspektiva në të ardhmen

6. Konkluzione dhe perspektiva në të ardhmen

Mbrojtja e interesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e shërbimeve, kundrejt një çmimi të arsyeshëm, bërë një nga detyrat kryesore të Entit Rregullator të Ujit. Nga ana tjetër synimi kryesor i ERRU është të inkurajojë efikasitetin dhe përmirësimin e atyre shërbimeve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë tek konsumatorët.

Për Rregullatorin rezultatet e këtij raporti krijojnë drejtimet kryesore të rregullimit në të ardhmen për të bërë të mundur përmbushjen e misionit dhe vizionit të tij.

Me gjithë përpjekjet e bëra për të arritur në standartet e duhura të cilësisë së shërbimit për konsumatorët shumë aspekte që kanë të bëjnë me shërbimet që ofrojnë shoqëritë dhe menaxhimin e tyre kanë nevojë për përmirësime thelbësore.

Rritja e pavarësisë financiare dhe menaxhimi i përgjithshëm

Për të tretin vit radhazi shoqëritë ujësjellës & kanalizime (parë si mesatare e tregut) arrijnë të mbulojnë tërësisht kostot operative, duke arritur në një nivel mesatar mbulimi prej 114%. Kjo tregon për një përmirësim të gjendjes financiare të shoqërive. Gjithësesi vetëm 4 shoqëri nga 58 mbulojnë tërësisht kostot (Tirana, Shkodra, Gjirokastra dhe Pogradeci) ndërkohë që mbulimi mesatar i kostove totale të të gjitha shoqërive është rreth 85% gjë që tregon se shoqëritë ende varen nga subvencioni i qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Për fare pak shoqëri situata financiare është mëse e qëndrueshme (mbulojnë tërësisht kostot) ndërkohë që shumica e shoqërive të vogla dhe të mesme ende nuk mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve totale për aktivitetin e shoqërive. Ky është një sinjal i qartë se shoqëritë nuk duhet ta shohin menaxhimin si një çështje thjesht administrimi dhe organizimi të punës së shoqërisë por si e vetmja mënyrë për ta bërë shoqërinë të aftë për të ofruar shërbime (mundësisht në të gjithë zonën e mbulimit dhe në mënyrë të vazhdueshme). Përmirësimi i menaxhimit vjen prej njohjes së kostove, masave për ti ulur ato, mbledhjes së të ardhurave dhe investimeve të mirëmenduara. Kjo është edhe arsye pse ERRU mbështet ato shoqëri që përmirësojnë treguesit e performancës, duke vendosur objektiva në rritje nga viti në vit.

Si një mënyrë për të ndikuar direkt mbi rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive ERRU e ka bazuar miratimin e aplikimeve për tarifa në analizën e gjendjes aktuale të shoqërisë, arritjen e objektivave të vendosur nga rregullatori dhe mbi nevojën për zbatimin e planeve të biznesit të shoqërive përkatëse. Në këtë mënyrë tarifa nuk është parë thjesht si një mjet me atë të cilit

shoqëria ka nevojë të mbulojë kostot e saj por si një instrument politikash për krijimin e një tregu të qëndrueshëm.

Eksperienca gjatë miratimit të tarifave nxori në pah se përmirësime financiare mund të arrihen në mënyrë të menjëhershme duke përmirësuar me jo shumë mund tregues performance siç janë: efienca e stafit (numri i punonjësve për 1000 lidhje), rritjen e arkëtimeve, monitorimi i prodhimit të ujit, dhe mbi të gjitha drejtimin e investimeve drejt atyre që sjellin efienca në përdorimin e energjisë elektrike.

Faza e dytë e projektit “Reforma në sektorin e ujit në Shqipëri” e GLZ po punon për të adresuar çështjen e efienca së energjisë në shoqëritë UK. Nga analiza e hollësishme e gjendjes ekonomiko-teknike të 6 shoqërive është arritur në përfundimin se përmirësime modeste në shoqëritë përkatëse do të sillte një ndryshim të dukshëm në uljen e kostove për energjinë elektrike për këto shoqëri.

Për rregullatorin është alarmant një nivel arkëtimi prej vetëm 82% (mesatarisht për të gjitha shoqëritë) të faturave. Ka shoqëri që nivelin e arkëtitimit në nivele aq të ulëta sa informaliteti duket si një fenomen normal. Kjo sjell nevojën e vendosjes së sistemeve elektronike të faturimit dhe ndjekjen e detyrimeve duke kërkuar edhe mbështetjen e institucioneve të tjera publike për përmirësimin e situatës.

Rregullatori do të vazhdojë ta konsiderojë instrumentin e tarifës si një mjet të rëndësishëm për përmirësimin e treguesve të efienca së duke u munduar të influencojë edhe akordimin e investimeve nga qeverisja qendrore nëpërmjet formulave që krijojnë incentivë për shoqëritë UK : “performuesit më të mirë shpërblehen”

Përmirësimi i treguesve teknik të shoqërive UK

Enti Rregullator është përgjegjës për liçensimin e shoqërive UK, mandat të cilin e realizon duke vlerësuar tregues teknik dhe ekonomik të operatorëve. Treguesit teknik marrin po aq rëndësi për rregullatorin edhe gjatë vlerësimit të aplikimeve për tarifa pasi Treguesit Kryesorë të Performancës kanë në përbërje edhe tregues tërësisht teknik si: niveli i matjes, uji pa të ardhura, efienca e stafit si edhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë, përpos kërkesave specifike teknike që janë kusht për personelin drejtues dhe teknik të shoqërisë që liçencohet.

Niveli i lartë i humbjeve të ujit është problemi më serioz në sektor i cili ka impakt negativ për qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK por edhe për cilësinë e ujit për konsum publik. Nga reduktimi i humbjeve të ujit përfitimet do të ishin të gjithëanëshme për shoqëritë dhe konsumatorët. Përfitimet financiare për shoqëritë vijnë nga rritja e nivelit të faturimit ose nga zvogëlimi i prodhimit apo zvogëlimi i nevojave për shtimin e kapaciteteve prodhuese, përmirësimi i kualitetit të ujit. Për shumë shoqëri nivelet e larta të këtij treguesi janë të lidhura jo vetëm me gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë por edhe me menaxhimin jo të mirë të tyre. Një hap i parë për përmirësimin e situatës është evidentimi, ndërprerja apo legalizimi i lidhjeve të paligjshme. Operatorët duhet të kenë plane të qarta veprimi për sa i përket angazhimeve konkrete për reduktimin e humbjeve të ujit.

ERRU vazhdimisht ka kërkuar vendosjen e matësve si në pikat e prodhimit dhe për konsumatorët individual në mënyrë që të hartohen bilance të sakta të ujit dhe planveprimeve konkrete për reduktimin e tyre. Kjo do t'i ndihmonte shoqëritë në gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme dhe sa më pak të kushtueshme.

ERRU është duke monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësave. Rezultatet e deritanishme tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësave për konsumatorët jofamiljar proces që duhet të kishte përfunduar në vitin 2010. ERRU do të vazhdojë të kërkojë nga shoqëritë vendosjen e matësave për këtë kategori konsumatorësh si dhe për të gjitha lidhjet e reja me qëllim reduktimin e nivele të larta të shërbimit.

Ofrimi i shërbimeve

Deri në fund të vitit 2013 vetëm 81% e popullatës mbulohet me shërbim të ujit të pijshëm dhe vetëm 51% e saj merr shërbimin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Situata është në një „status quo“ prej vitesh me rradhë (tregues të pandryshuar për gati 5 vite).

Edhe pse ofrimi i ujit të pijshëm është përmirësuar me më pak se një orë (mesatarisht për të gjitha shoqëritë) për atë pjesë të popullsisë që e merr këtë shërbim ai ofrohet në një kohëzgjatje prej rreth 11.5 orë, duke qenë ende larg objektivit „ujë pa ndërprerje për të gjithë popullatën“.

Nga ana tjetër cilësia e ujit të pijshëm pavarësisht burimeve shumë cilësore të ujës-jellësave është jo 100% brenda standarteve kombëtare për këtë produkt gjë që vjen kryesisht nga problemet në shpërndarje dhe mungesës së një procedure standard për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm nga këto shoqëri.

Cilësia u ujit të pijshëm është e lidhur ngushtë me shumë tregues të tjerë të performancës, pasi disa nga faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit dhe janë të lidhura me ç'rregullimet në furnizim : (i) furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, (ii) ndryshimet në presionin e ujit, (iii) shpimi i tubave për lidhje të paligjshme, (iv) mbajtja e ujit në depozita, dhe (v) pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët për të kompensuar presionin e ulët të rrjetit.

ERRU synon që cilësinë e ujit në raportin e performancës për vitin 2014 ta vlerësojnë tërësisht në të dhënat e marra nga ISHP si një e dhënë e besueshme që garanton jo vetëm informim të saktë por edhe vlerësim real të shoqërive në lidhje me cilësinë e ujit që ata prodhojnë dhe shpërndajnë për konsumatorët.

Shërbimi me kanalizime dhe trajtimi i ujrave të ndotura është ende larg objektivave kombëtar dhe atyre të vendosur nga Rregullatori. Megjithatë vlen të përmendim se vazhdojnë investimet e rëndësishme për rehabilitimin apo zgjerimin e sistemit të kanalizimeve.

Gjithashtu përmirësime të rëndësishme të këtij shërbimi janë bërë edhe në drejtim të cilësisë së këtij shërbimi me vënia në funksionim e impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura, impakti i të cilave është i drejtpërdrejtë në mjedis. Aktualisht janë në punë 5 të tilla dhe priten të fillojnë nga puna edhe impiante të tjera. Aktualisht rrjeti i monitorimit të shkarkimeve urbane përbëhet nga 35 - 40 stacione (pika) monitorimi në nëntë zona/qytete (lumenj dhe / ose zona bregdetare) frekuencën 4 here në vit ose me fushata gjatë periudhës së verës.

Besueshmëria e të dhënave

Enti Rregullator beson se hartimi i analizave dhe ofrimi i zgjidhjeve është i pavarësishëm nëse nuk bazohet në të dhëna të sakta dhe të besueshme. Eksperienca e punës së gjithë këtyre viteve jo vetëm gjatë procesit të shqyrtimit të tarifave por dhe në raste përgatitjeve të raporteve për sektorin ka treguar se të dhënat janë të pasakta, duke krijuar një pamje jo të qartë për secilën shoqëri më vete e për gjithë sektorin në tërësi.

Dy ushtrime të realizuara nga ERRU gjatë vitit 2013 nxorën në pah diferenca të mëdha të të dhënave të deklaruara nga shoqëritë.

Së pari të dhënat mbi cilësinë e ujit të pijshëm tregojnë se vetëm 4 shoqëri nga 47 që ishin deklaruar si të tilla, ofronin ujë brenda parametrave normal për elementin e klorit, rezultat ky që e vendosi rregullatorin përpara vendimit për të mos e përdorur më informacionin e marrë nga DPUK në lidhje me treguesit e cilësisë së ujit.

Së dyti të dhënat që rezultuan nga hartimi i bilanceve të ujit, pavarësisht problematikës në llogaritjen e tyre dhe kuptimit të saktë të metodologjisë, ishin shumë të ndryshme nga ato që po këto shoqëri kishin deklaruar për komponentë të bilancit të ujit pranë DPUK (si: uji i prodhuar, humbjet teknike, humbjet tregtare, zona e mbulimit me shërbim, shërbimi i matur etj.).

Kjo eksperiencë e bëri ERRU të punojë në drejtim të monitorimit të sektorit duke krijuar fillimisht një bazë të besueshme të dhënash si një nevojë emergjente për të rritur cilësinë e rregullimit të sektorit. Nga ana tjetër rregullatori e sheh cilësinë e raportimit jo vetëm në funksion të rregullimit por mbi të gjitha si hapin e parë për të bazuar vendimarrjen në menaxhimin e vetë shoqërive e më tej të hartimit të politikave të sakta kombëtare për gjithë sektorin.

Perspektiva për të ardhmen

ERRU do të vazhdojë të monitorojë performancën e sektorit në tërësi si dhe aspekte të veçanta të këtij shërbimi, rezultatet e të cilave do të bëhen publike dhe do të jenë objekt diskutimi me palët e interesit më qëllim përmirësimin e qëndrueshëm të shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve. Në veçanti do të punohet për të rritur saktësinë e të dhënave. Kontrolli dhe verifikimi i të dhënave të raportuara do të jetë një nga prioritetet e punës së rregullatorit.

Gjithashtu, në të ardhmen treguesit kryesorë të përzgjedhur për vlerësimin e performancës së shoqërive do të rishikohen në mënyrë që vlerësimi për çdo operator të jetë më e gjerë dhe më e detajuar për të evidentuar shkaqet dhe problemet që lidhen me nivelin dhe ecurinë e tyre.

Viti 2014 do të jetë një vit tjetër progresi për ERRU në drejtim të një performace gjithnjë në rritje në ushtrimin e funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit rregullator. ERRU do të vazhdojë të ndërmarrë iniciativë që do të fokusohen në arritjen e objektivave të tij. Për të identifikuar pikat e nisjes për një efikasitet më të mirë të shoqërive UK është e nevojshme të zhvillohen analiza më të detajuara në veçanti për treguesit si: uji pa të ardhura, niveli i matjes, efikasiteti e stafit, efikasiteti e energjisë. e norma e arkëtimit Në të ardhmen Rregullatori do të kërkojë shoqërive UK të mbështesin kërkesën e tyre për ndryshimin e tarifave mbi bazën e këtyre analizave. ERRU është duke punuar për hartimin e udhëzuesve përkatës si instrumenteve shumë të rëndësishëm që do të ndihmojnë shoqëritë në këtë drejtim.

Vlerësimi i kostove për çdo shërbim të kryer. Për ERRU ndarja e shpenzimeve sipas qëndrave të kostos merr një rëndësi të veçantë në përcaktimin e kostove të domozdoshme e të arsyeshme për kryerjen e çdo shërbimi

Menaxhimi i aseteve Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve mundëson jo vetëm një menaxhim më të mirë të aktiveve fikse por edhe uljen e këtyre kostove

Efikasiteti e energjisë; Ulja e shpenzimeve për energjinë duhet të jetë një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive, pasi aktualisht këto shpenzime kanë peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. ERRU mbështet iniciativën e GIZ për trajnimin e shoqërive UK për këtë qëllim, pasi edhe përmirësime modeste sjellin ndryshim të dukshëm në uljen e kostove për energjinë elektrike.

Bilanci i ujit si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura. ERRU do të vazhdojë punën e nisur në vitin 2013 për plotësimin dhe analizën e tij nga çdo shoqëri.

Pa dyshim *Planet e Biznesit* janë instrumenti më i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të shoqërive UK. ERRU mbështet të gjitha ato shoqëri që kanë hartuar planet e tyre të biznesit si dhe ato që janë duke punuar për këtë qëllim. Gjithashtu, Rregullatori do të nxisë të gjitha shoqëritë e tjera të punojnë për të patur planet e tyre të biznesit.

ERRU edhe në të ardhmen do të punonjë për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin dhe bashkëpunimin ndër institucional për të krijuar ekuilibrin e duhur ndërmjet ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorëve.



7

Aneks: Të dhënat kryesore
të përzgjedhura



Tabela 11. Të dhënat kryesore të shoqërive për tre grupet

Nr.	Aktiviteti	Operatori	Nr. i klientëve ujësjellës	Nr. Klientëve kanalizime	Nr. i punonjësve	Prodhimi (m ³)	Faturimi ujë (m ³)	Shuma e Faturuar U&K [000 Lek]	Të ardhura të tjera [000 Lek]	Shuma e Arkëtuar U&K [000 Lek]	Kosto O&M UK [000/lek]	Kosto Totale UK [000/lek]
Grupi 1	UK	Tirane	176,122	159,382	1,358	108,912	33,267	2,392,594	296,005	2,664,298	1,484,743	2,111,515
	UK	Durrës	73,044	46,734	622	27,006	7,825	702,312	65,627	578,515	1,143,874	1,239,153
	UK	Vlore	41,268	-	241	24,974	5,302	282,358	2,576	163,983	293,781	464,461
	UK	Elber sh.p.k	30,229	13,358	213	14,057	2,757	281,602	7,407	215,477	213,582	293,507
	UK	Fier	28,404	21,426	358	11,358	4,243	358,417	8,491	250,076	287,686	369,682
	UK	Shkoder	27,165	24,422	213	12,478	3,910	266,605	5,959	145,199	220,006	256,719
	UK	Berat - Kucove	25,037	20,991	264	10,508	2,963	204,430	5,766	147,274	154,644	230,128
	UK	Kavaje	22,953	5,967	201	2,818	1,824	94,254	7,941	68,236	108,477	219,161
	UK	Korce	20,832	19,825	98	3,277	2,442	267,677	14,839	254,784	176,929	328,809
	U	Elbasan fshat	17,330	-	223	3,172	2,183	106,459	4,813	97,283	170,818	182,032
	UK	Sarande	16,218	15,378	88	4,487	1,155	81,948	2,024	63,597	83,223	137,422

Tabela 11. Të dhënat kryesore të shoqërive për tre grupet

Nr.	Aktiviteti	Operatori	Nr. i klientëve ujësjellës	Nr. Klientëve kanalizime	Nr. i punonjësve	Prodhimi (m ³)	Faturimi ujë (m ³)	Shuma e Faturuar U&K [000 Lek]	Të ardhura të tjera [000 Lek]	Shuma e Arkëtuar U&K [000 Lek]	Kosto O&M UK [000/lek]	Kosto Totale UK [000/lek]
Grupi 2	UK	Pogradec	14,106	10,466	102	2,337	1,276	105,576	31,116	123,302	75,894	122,201
	UK	Lushnje	10,716	7,171	128	4,673	1,155	84,233	1,188	69,883	92,722	129,249
	UK	Gjirokaster	9,238	2,389	93	5,828	1,440	75,784	3,200	71,533	65,279	69,755
	UK	Lezhe	7,478	7,477	80	2,198	1,127	105,329	3,239	74,932	95,504	132,563
	U	Korce fshat	5,988	-	50	1,027	667	13,959	48	12,824	34,531	38,073
	U	Lushnje fshat	5,835	-	79	565	399	26,342	42	18,082	47,372	54,104
	U	Kurbin	5,742	-	117	4,097	1,219	51,357	265	33,750	100,737	104,554
	UK	Kukes	4,973	3,434	71	965	796	30,897	328	17,415	37,805	51,155
	UK	Librazhd	4,780	4,447	63	703	541	33,783	3,000	33,098	33,447	40,072
	U	Patos	4,652	-	112	2,282	1,302	36,435	239	27,381	141,192	187,392
	UK	Rrogozhine	4,128	1,636	32	457	290	10,004	-	7,746	18,080	25,120
	UK	Burrel	4,080	3,214	46	1,412	534	21,472	49	19,488	15,569	23,669
	UK	Mallakaster	4,012	1,515	85	-	474	27,965	146	22,053	64,439	70,560
	UK	Gramsh	3,949	-	52	1,020	668	26,085	-	22,738	25,927	35,500
	UK	Kruje	3,574	3,045	39	1,144	414	20,842	534	14,372	19,013	39,537
	UK	Tepelene	3,537	1,775	70	929	444	25,675	213	19,112	36,969	48,800
	UK	Peshkopi	3,426	-	39	1,633	725	25,285	60	17,672	20,096	27,654
U	Permet		3,287	-	38	451	309	18,396	867	17,461	20,276	23,645

Tabela 11. Të dhënat kryesore të shoqërive për tre grupet

Nr.	Aktiviteti	Operatori	Nr. i klientëve ujësjellës	Nr. Klientëve kanalizime	Nr. i punonjësve	Prodhimi (m³)	Faturimi ujë (m³)	Shuma e Faturuar U&K (000 Lek)	Të ardhura të tjera (000 Lek)	Shuma e Arkëtuar U&K (000 Lek)	Kosto O&M UK (000/lek)	Kosto Totale UK (000/lek)
Grupi 3	UK	Peqin	2,884	-	50	548	419	28,589	-	10,363	39,793	93,748
	UK	Divjake	2,786	-	38	227	177	9,276	182	8,948	15,237	17,349
	U	Ura Vajgurorë	2,710	-	36	1,100	365	20,413	2,348	21,656	25,899	27,585
	U	Bulgize	2,684	-	45	813	573	14,777	14	10,683	21,907	33,626
	U	Bilisht	2,546	-	22	733	282	13,295	1,999	13,390	20,167	21,723
	U	Delvine	2,366	1,117	32	424	277	21,049	663	16,413	20,593	22,481
	U	Shkoder fshat	2,287	-	79	1,273	516	21,150	-	11,780	53,836	93,592
	U	Fushe Kruje	2,150	1,765	36	527	229	9,336	190	8,179	21,137	31,956
	U	Malsi e Madhe	2,093	-	33	1,420	360	12,921	-	6,355	9,269	20,874
	UK	Orikum	1,898	-	18	445	222	8,111	302	4,052	26,476	28,444
	U	Corovode	1,761	-	33	571	237	8,862	-	4,370	20,576	33,762
	U	Erseke	1,664	1,664	20	575	195	11,125	1,642	11,362	11,236	13,510
	U	Polican	1,600	-	38	562	213	11,142	-	7,793	24,785	29,202
	UK	Tropoje	1,516	-	31	1,295	315	12,681	60	3,704	13,738	17,218
	U	Selenice	1,506	-	11	455	131	4,876	-	3,356	11,239	11,755
	U	Has	1,361	-	31	544	282	8,675	-	2,606	17,646	21,498
	U	Mirdite	1,200	1,094	27	912	258	17,491	-	9,912	28,036	30,460
	U	Bashkia Puke	1,117	1,114	20	360	150	7,871	-	8,688	9,683	24,363
	UK	Kelcyre	1,002	-	14	636	107	5,229	46	4,713	8,302	9,206
	UK	Vau i Dejes	911	-	8	595	176	5,131	-	2,858	11,912	13,412
	U	Libohove	783	567	7	183	128	3,909	-	2,966	8,934	10,668
	U	Fushe Arrez	560	505	9	536	110	3,896	1,067	3,386	6,663	17,175
	UK	Rubik	534	510	12	128	111	4,692	52	5,356	5,974	6,437
	UK	Puke fshat	523	78	19	420	127	2,511	-	1,877	8,292	11,625
	UK	Kraste	413	353	12	166	104	3,252	-	2,993	5,290	16,154
	UK	Gjirokaster fshat	132	-	10	456	366	1,358	-	767	5,612	7,316
	UK	Novosele	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	U	Bradashesh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	UK	Himare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 12. Tarifet e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve

Nr	Aktiviteti	Operatori	Nr i konsumat. Uje	Tarifat për ujin e pijshëm (lek/m3)			Tarifë shërbimi (lek/lidhje/muaj)	Tarifat për kanalizimet (lek/m3)		
				Familjar	Buxhetor	Privat		Familjar	Buxhetor	Privat
	UK	Tiranë	176,122	45	120	135	100	11	30	35
	UK	Durrës	73,044	58	110	120	100	35	50	50
	U	Vlorë	41,268	30	60	80	80	11	13	13
	UK	Elber sh.p.k	30,229	38	115	130		8	25	30
	UK	Fier	28,404	52	100	120	200/200/200	13	16	18
	UK	Shkodër	27,165	40	110	110	100	15	20	20
	UK	Berat - Kuçovë	25,037	42	120	120	100/200/200	10	18	20
	UK	Kavajë	22,953	38	80	100		15	20	20
	UK	Korçë	20,832	60	105	140	100	30	50	50
	U	Elbasan Fshat	17,330	36	110	110	100			
	UK	Sarandë	16,218	44	120	120	100	16	25	25
	UK	Pogradec	14,106	22/62	37/111	37/111	200+100/400+100/400+150	11./33	12./36	12./36
	UK	Lushnjë	10,716	52	120	130	100/200/200	14	18	20
	UK	Gjirokastrë	9,238	38	112	124	50/50/50	8	14	14
	UK	Lezhë	7,478	55	120	130	150/200/200	14	18	22
	U	Korçë Fshat	5,988							
	U	Lushnjë Fshat	5,835	60	70	100				
	U	Kurbin	5,742	30	80	120	50			
	UK	Kukës	4,973	25	60	80		7	15	20
	UK	Librazhd	4,780	38	100	100		13	22	23
	U	Patos	4,652							
	UK	Rrogozhinë	4,128	48	90	100	50/100/100	10	12	12
	UK	Burrel	4,080	23	60	80		2	4	6
	UK	Mallakastrë	4,012							
	U	Gramsh	3,949	32	90	90				
	UK	Krujë	3,574	33	80	80		8	12	12
	U	Tepelenë	3,537	33	100	120		12	20	20
	U	Peshkopi	3,426	27	65	85				
	U	Përmet	3,287	40	110	120	100/100/200			

Tabela 12. Tarifat e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve

UK	Peqin	2,884	30	90	100	50			
U	Divjakë	2,786							
U	Ura Vajgurore	2,710	40	90	100				
U	Bulqizë	2,684	17	55	75	100			
U	Blisht	2,546	38	100	110	50			
U	Delvinë	2,366	48	100	100				
U	Shkodër Fshat	2,287	50	120	120				
UK	Fushë Krujë	2,150							
U	Malësi e Madhe	2,093							
U	Orikum	1,898	25	70	75	100			
U	Çorovodë	1,761	27	80	95				
UK	Ersekë	1,664	32	60	80		6	6	8
U	Poliçan	1,600	37	80	95				
U	Tropojë	1,516	19	60	80				
UK	Selenicë	1,506	30	80	100				
U	Has	1,361							
UK	Mirditë	1,200	30	100	115		10	15	15
UK	Bashkia Pukë	1,117	25	60	80		5	8	10
U	Këlcyrë	1,002							
U	Vau i Dejës	911							
UK	Libohovë	783							
UK	Fushë Arrëz	560							
UK	Rubik	534	30	70	100		7	10	15
UK	Pukë Fshat	523							
UK	Krastë	413	30	80	100		7	10	15
U	Gjirokastër Fshat	132	25	60	60				
UK	Himarë								
U	Novoselë		33	50	70				
UK	Bradashesh								

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

